E hënë, 4 dhjetor 2023

[Seancë e hapur]

[Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

--- Seanca fillon në orën 10.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë 04765, ka disa aspekte paraprake të cilat duhen trajtuar.

Së pari do vini të gjithë re, që Gjykatësi Gaynor po na ndjek me videolidhje, se ka pasë probleme me transportin.

Gjykatësi Gaynor, na dëgjoni mirë?

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po, ju dëgjoj shumë mirë. Mirëmëngjesi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa i takon planifikimit për ditën e sotme, si e shihni, ne sot filluam më vonë se herët e tjera. Seanca e parë do të zgjasë 10.00 me 11.30, pastaj do të bëjmë gjysmë ore pushim, pastaj nga ora 12.00 deri në 1.30, një orë pushim dhe do rifillojmë në orën 2.30 deri në orën 4.00.

Së dyti, ju kujtoj të gjithëve se kemi vetëm dy seanca këtë të mërkurë më datën 6 në sallën e gjyqit, dy seancat e

para do të jemi në sallën e gjyqit, por nuk do të kemi mundësi të mbajmë një seancë të tretë.

Së treti, ju informojë se nuk do të ketë seancë të hënën më 19 shkurt 2024. Reflektoheni këtë në kalendarin tuaj. Sepse është data e pavarësisë së Kosovës dhe është pushim kombëtar në Kosovë, kështu që dhe ne atë ditë nuk do të mbajmë asnjë seancë.

Tani do të vazhdojmë me një urdhër me gojë nga Trupi Gjykues për pranimin e versionit të redaktuar publik të provës materiale P680.

E cila është pranuar më 7 nëntor 2023 përmes Dëshmitarit 03825. Ka qenë një transkript dhe përkatësisht kanë qenë faqet 9511-9512. Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja ka nxjerrë versionin e redaktuar publik të provës materiale 680 më 16 nëntor 2023 me numrin e ERN 034236 deri në 034287 RED PRV.

Trupi Gjykues e kupton që Mbrojtja nuk ka kundërshtime për redaktimet që janë bërë në PRV. Dhe, rrjedhimisht, e pranon materialin me numër 034236 deri në 034287 RED PRV dhe i kërkon Sekretares së Gjykatës ta bashkëngjisë këtë material me provën materiale ekzistuese që mban numrin P680.

Me kaq mbyll edhe urdhrin me gojë.

Tani, besoj se ju, z. Roberts, deshët të parashtroni diçka për Trupi Gjykues.

Z. ROBERTS: [Përkthim] Shkurtimisht. Thjesht dua të informoj Trupin Gjykues se dje dëshmitari që do të kthehet sot

ishin ulur në fluturim ngjitur me një nga anëtarët e ekipit të Mbrojtjes. Nuk pati kurrfarë komunikimi. Por doja të informoja Trupin Gjykues dhe Prokurorinë lidhur me këtë fakt. Thjesht për t'ju vënë në dijeni në qoftë se është nevoja për ta trajtuar më tej.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E vlerësojmë.

Z. KEHOE: [Përkthim] Diçka që ka lidhje me ngjarjet e javës së fundit. Klientit tim i është refuzuar kontakti për familjarët 17 ditët e fundit.

Z. PACE: [Përkthim] Ju kundërshtoj sepse nuk kemi marrë asnjë njoftim për këtë. Nuk është e përshtatshme për ta diskutuar këtë dhe nuk është në bazë të Urdhrit për zhvillimit të Gjykimit. Në bazë zë paragrafit 7 të këtij vendimi, nuk është ky momenti për ta diskutuar këtë, sidomos nuk ka lidhje me dëshmitarin e radhës. Kështu që do ju lutesha që ta diskutoni në një moment të dytë.

Z. KEHOE: [Përkthim] A mund ta mbaroj unë fjalinë dhe mos të më ndërprisje.

Z. PACE: [Përkthim] Do kishim vlerësuar të na njoftonit paraprakisht. Nuk është ky momenti i përshtatshëm. Le ta diskutojmë këtë në një moment pasi të jepet njoftimi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shkurtimisht më thoni njëherë për çfarë është.

Z. KEHOE: [Përkthim] Kontakti mes familjes sime [sipas përkthimit] dhe familjarëve të tij sepse i është mohuar kjo 17

ditët e fundit. Kërkoj një zgjidhje nga Trupi Gjykues. Të paktën të flasë me telefon, me Zoom.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e keni urdhrin me shkrim.

Z. KEHOE: [Përkthim] Po pra, por nuk është zbatuar dhe 17 ditët e fundit i është refuzuar kontakti me familjarët.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Urdhri ynë do të zbatohet sa më shpejt të jetë e mundur dhe do lejohen këto vizita, pra, në këtë formë.

Mirë. Vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 04765.

Vërej që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në sallën e gjyqit, përfshirë edhe z. Krasniqi. Faleminderit.

Sekretare, mund ët sillni dëshmitarin në sallë.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi, Dëshmitar.

DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do të vazhdojmë me dëshminë tuaj dhe supozoj që do mbarojmë brenda dite. Së pari do të ketë disa pyetje të mëtejshme Prokuroria, nëse ka. Dhe më pas anëtarët e Trupit Gjykues do të kenë disa pyetje për ju.

Ju kujtoj t'u përgjigjeni pyetjeve qartë, me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkojini personit që po flet që ta përsëris pyetjen ose thjesht thoni

që "nuk e kuptoni" dhe ata do ta sqarojnë pyetjen për ju. Gjithashtu, mos harroni të na thoni se ku e bazoni njohurinë lidhur me faktet dhe rrethanave për të cilat do t'ju bëjnë pyete.

Ju rikujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të vërtetën sikurse vetë e thatë përmes deklaratës solemne.

Flisni afër mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara se t'i jepni përgjigje pyetjes dhe flisni ngadalë në mënyrë që t'ju ndjekin edhe përkthyesit.

Nëse keni nevojë për ndonjë pushim, na vini në dijeni dhe do të bëjmë organizimet e nevojshme.

Prokuror, fjala është për ju në qoftë se keni pyetje shtesë.

Z. PACE: [Përkthim] Ne thamë që na nevojitej një minutë, po në fakt nuk kemi më asnjë pyetje shtesë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Do të kemi disa pyetje nga Trupi Gjykues. Do të fillojmë me Gjykatësin Barthe. Faleminderit.

Z. KEHOE: [Përkthim] Përpara se të flasë Gjykatësi Barthe. Dhe ju kërkoj ndjesë që ju ndërpreva.

Ka qenë një dokument në pyetjet shtesë që duam, që mund ta trajtojmë ne, në fakt në vijim të pyetjeve që do të diskutojnë Gjykatësit.

Ka qenë një dokument që nuk ka qenë fillimisht në listë dhe është vendosur më pas dhe mund të jetë një dokument që

mund të lindë, që mund të diskutohet nga pyetjet e gjykatësve. Kështu që dua t'ju informojë paraprakisht që unë do kem disa pyetje shtesë lidhur me këtë dokument, sepse i kam bërë pyetje për një dokument që nuk ka qenë në listën e tyre pa na njoftuar paraprakisht edhe tani flasim për njoftimet, Mbrojtja ndërkohë s'ishte njoftuar dhe ne kemi disa pyetje shtesë lidhur me këtë dokument të cilin ata që e kanë trajtuar.

Z. PACE: [Përkthim] Ne mendojmë që është më mirë t'i bëjnë tani pyetjet atëherë dhe para se të fillojë Trupi Gjykues me pyetjet e veta lidhur me këtë dokument.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

DËSHMITARI: W04765 [Vijon]

Pyetje nga Trupi Gjykues:

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëmëngjesi, Dëshmitar.

PË. Mirëmëngjesi edhe juve.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sikurse e merrni me mend, Trupi Gjykues e ka ndjekur me interes dëshminë tuaj. Sidoqoftë, kemi evidentuar disa pika ku unë dhe kolegu im gjykojmë se kemi nevojë për më shumë sqarim prej jush apo më shumë informacion prej jush. Tani unë do të ndjek në rend kronologjik deklaratat që keni bërë para dy javësh, do trajtoj më shumë se një aspekt, por nuk ka problem, e rëndësishme është që ta trajtojmë dëshminë tuaj se për ne kjo është shumë, shumë e rëndësishme. E kuptoni këtë?

PË. E kuptoj.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Filloj me ditën e parë të dëshmisë tuaj më 13 nëntor 2023.

Gjatë pyetjeve që ju bëri Prokurori, ju na thatë se biseda mes Halil Qadrakut dhe komandant Drinit për faktin që z. Qadraku do bëhet shef i zbulimit dhe kundërzbulimit në zonën operative të Pashtrikut është bërë në Shqipëri kjo bisedë dhe se Drini i ka thënë z. Qadraku, citoj, "Do të emërohesh në nivel zone si shefi i zbulimit dhe kundërzbulimit G2".

Është faqen 9958 të transkript të asaj dite.

Tani unë kam këtë pyetje: Kur është bërë kjo bisedë mes komandant Drinit dhe z. Qadraku në cilin muaj dhe në cilin vit?

PË. Z. Qadraku ka kaluar kufinin Shqipëri-Kosovë, Kosovë-Shqipëri, më shumë se 30 herë gjatë luftës. Në kohën kur Drini ka qenë në Shqipëri nga shtatori 1998 deri në dhjetor, në 14 dhjetor 1998, në atë kohë janë takuar me Qadrakun në Shqipëri, diku në Krumë apo Kukës, nuk e di vendin ku, janë taku, sigurisht më shumë se një e dy herë, tri herë.

Duke e pa veprimtarinë e Qadrakut, Drini, që po rrezikon aq shumë duke fut armë edhe njerëz anasjelltas Shqipëri-Kosovë dhe të plagosur duke dërgu prej Kosove në Shqipëri, përkushtimin e z. Qadraku, ai thotë "ti e meriton dhe duhet të jesh në shërbimin zbulim kundërzbulimi" atje i premton, thotë "Kur të kthehemi në Kosovë ti do ta kesh këtë funksion".

Kështu ka qenë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pra, ka qenë mes shtatorit dhe 14 dhjetorit të 1998, kështu?

PË. Po, ashtu ka qenë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Ju keni qenë vetë i pranishëm gjatë kësaj bisede?

PË. Jo, unë tanë kohën kam qenë në luftë nga dita që kam hy në luftë në Kosovë prej 7 qershorit 1998 deri në përfundim të luftës s'kam dalë nga fusha e luftës asnjë minutë, asnjë ditë. Po këtë ma ka thënë Qadraku.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Ishte vendimi i komandant Drinit që ta emëronte, domethënë - më falni - vendimi i komandant Drinit për të emëruar z. Qadraku si G2, me sa dini ju, u miratua më pas nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së?

PË. Po. U miratua në janar 1999.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja tjetër lidhet me dëshminë që keni dhënë po më 13 nëntor, konkretisht, është reflektuar në faqen 9963 të transkriptit.

Sekretare e Gjykatës, a mund të shohim në ekran provën materiale P500. Vetëm në versionin në shqip. Ju lutem të shkojmë në faqen 2.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi pak probleme me videolidhjen me Gjykatësin Gaynor, duhet ta ndaloj, duhet të hyj e të dal në mënyrë të vazhdueshme duke

filluar nga pas pesë minutash.

Kështu që kijeni këtë parasysh, thjesht për të informuar, që do ketë nevojë të shkëputet nga videolidhja herë pas here.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

Dëshmitar, shihni në fund të faqes, e shihni fjalën "SHIK" që është përkthyer më pas në anglisht SHHQ - më falni - e shikoni fjalën "SHIK" te versioni?

PË. Po, po e shof në fund të faqes shkruan "SHIK-u pranë Shtabit të Përgjithshëm".

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Besoj se keni diskutuar gjatë me z. Emmerson, që është Mbrojtja e Veselit, për fjalën "SHIK" dhe nga ka buruar fjala SHIK.

Unë po ju pyes, a po thoni ju që nuk ka pasur -- ju po thoni që s'ka pasur drejtori zbulimi dhe kundërzbulimi në atë kohë në Shtabin e Përgjithshëm, konkretisht, në marsin e 1999, në momentin që pretendohet se është hartuar ky dokument, nuk ka rëndësi se çfarë emërtimi ka, a e ka SHIK a e ka ZKZ apo e ka G2, pra, ju thoni që nuk ka ekzistuar kjo?

PË. Nuk ka ekzistuar. Por Halili e ka bë, Halil Qadraku, për shkak se ka qenun i përgatitur teorikisht në Shqipëri dhe atje literatura ka qenë gjithmonë për SHIK-un fjala ka qenë për një shërbim sekret kombëtar të Shqipërisë. Dhe ai e ka shkruar "SHIK" duke menduar se edhe Kosova duhet ta ketë një shërbim të tillë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ta kuptoj tamam. Pra, ju po

thoni që nuk ka ekzistuar një drejtori e atillë në mars të 1999 në nivel të Shtabit të Përgjithshëm?

PË. Ndoshta në mars, ka fundi i marsit ka ekzistuar. Por kjo nuk e di datën kur e ka. Halili kur është emërtuar, Halil Qadraku, nuk ka pasë. Ka qenë vetëm person. Ma jep datën ta shoh nalt, të lutem.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në faqen 1 shkojmë.

PË. Nuk jam i sigurtë që ka pasë drejtori të zbulim kundërzbulimit në 14 mars 1999. Më vonë ka qenë. SHIK s'ka pasë absolutisht në atë kohë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po në qoftë se nuk ka qenë një drejtori e atillë, atëherë çfarë bënte z. Veseli aso kohe, mesa dini ju? A ka pasur ndonjë post zyrtar pranë Shtabit të Përgjithshëm apo pranë UÇK-së?

PË. Sa di unë në atë kohë nuk ka qenë e kompletume drejtoria e zbulim kundërzbulimit. Sigurisht z. Veseli ka qenë i angazhuar për atë drejtori, po s'ka pasë staf. Nuk ka pasë kompletim të drejtorisë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi Gaynor, doni të shkëputeni tani?

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po, do bëj një shkëputje tani.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na dëgjoni tani?

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po, ju dëgjoj. Faleminderit, Gjykatësi Smith. Mund të vazhdoni.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi Barthe, vazhdoni me pyetjet.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit dhe ju kërkojmë ndjesë për këtë ndërprerje, Dëshmitar.

Dëshmitar, pyetja ime po ashtu lidhet me atë që keni thënë ditën e parë të dëshmisë më 13 nëntor 2023. Sipas faqeve të transkriptit 9922-9923, ju thatë dhe unë citoj:

"Nëse merrnim urdhëresa nga Shtabi i Përgjithshëm, kryesisht i prisnim nga Adem Demaçi, e kisha idhull atë. Ai na ka thënë të mos jeni takuar me gazetarët pa lejen e tij. Kështu që nuk jepnim asnjë intervistë pa lejen e tij. Çdo gjë e prisnim prej tij. Përndryshe, nuk kishte ndonjë protokoll për urdhëresat nga asnjë palë. Nga niveli i zonave në nivelin më të ulët, struktura e komandimit funksiononte shumë mirë".

Dëshmitar, mesa dini ju, Adem Demaçi ka qenë personi përgjegjës për politikat e luftës apo ka qenë ai përfaqësuesi politik e zyrtarisht anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?

PË. Po. Me sa dija unë atëherë dhe sot, Adem Demaçi ka qenë përfaqësues politik dhe zyra e tij ka qenë me stafin e vet kompetente për politikat e luftës. Kështu që e vërtetë, ato që kam thënë ashtu është.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, a ka qenë ai anëtar i

Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së apo nuk ka qenë?

PË. Unë mendoj se ai e ka drejtu Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së politikisht. Kështu mendoj dhe atëherë kam mëndu kështu.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj. Sa urdhëresa keni marrë nga z. Demaçi përveç urdhëresës apo këshillës që ju kishte dhënë të mos takoheshit me gazetarë pa lejen e tij?

PË. Kam pasë rastësisht dy raste kur më kanë ardhë gazetarët me shkrimin e tij të nënshkruar nga ai një copë letër për të drejtën me marrë intervista prej meje. Dhe kështu në bazë të kësaj e kam ditë që patjetër duhet me pasë një dëshmi nga Adem Demaçi për t'i dhënë intervista gazetarëve të huaj. Më kujtohet prej Parisit ka qenë një ekip i gazetarëve francezë, lehtë e kam pasë, se gjuhën frënge e njof. Pra, kjo ishte ajo që kemi pritë edhe kemi parë nga Adem Demaçi.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Keni marrë urdhëresa të tjera përveç këtij?

PË. Dy raste thashë kam pasun kësi urdhëresa për bashkëbisedë me gazetarët. Dhe një rast, e kam taku unë në Lladrovc ku kemi bisedu goxha shumë gjatë që m'i ka sqarue disa projekte të tija për luftën.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Tani kam një temë krejt tjetër. Po më 13 nëntor 2023, kur ju bëri një pyetje Prokurori, ju thatë, se zbuluat nga një i afërmi juaj Jakup Muharremi se Skënder Hoxha dhe Shabaudin Cenaj "kanë

qenë të përfshirë drejtpërdrejt në ndalimin dhe keqtrajtimin e z. Morina". Ju thatë po ashtu që z. Morina ju tha se e kishin çuar në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së për ta ndëshkuar edhe më shumë. Dhe kjo është e reflektuar në faqet 9907-0012 dhe 9936-9937 të transkriptit.

Sidoqoftë, gjatë pyetjeve që u bëri Mbrojtja e Thaçit më 16 nëntor 2023, ju thatë që nuk ka pasë ndonjë konflikt të drejtpërdrejt mes Skënder Hoxhës dhe Jakup Muharremit, po dikush i afërt me Skënder Hoxhën kishte probleme, kishte një mosmarrëveshje me Jakup Muharremin përpara luftës dhe e shfrytëzoi situatën për ta çuar atje dhe për ta akuzuar si spiun, si kolaboracionist të shërbimit sekret të Jugosllavisë dhe e keqtrajtoi. Kjo është reflektuar në faqen 10246, rreshtat 14 dhe 19 të transkriptit.

Tani, kush ishte ky personi që ka pasur mosmarrëveshje me z. Muharremi përpara luftës dhe që shfrytëzoi situatën? A ua ka thënë këtë z. Muharremi gjatë bisedës që keni pasë me të?

PË. Me thënë të drejtën, ma ka thënë po e kam harru emrin. Duhet të jetë dikush nga Pirana, nga fshati Piranë, që kanë pasë konflikt para lufte këta. Dhe ai ka pasë ndikim te dikush i afërm të stafit të Hoxhës. Kështu që kjo është bë për shkaqe private krejtësisht për konflikt privat që ka pasë Jakup Muharremi me dikën tjetër. Kështu ka qenë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Por ju thatë se e morët vesh nga z. Muharremi se z. Hoxha dhe z. Qenaj [Sipas përkthimit]

kanë qenë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në ndalimin dhe keqtrajtimin e z. Muharremi. A mund të na thoni dhe një herë si ka qenë i përfshirë z. Hoxha dhe z. Qenaj të përfshirë në situatën e z. Muahrremi? Çfarë bënë saktësisht?

PË. Dikush tjetër nga ata, si duket ky Mullabazi a kush kanë qenë ata tjerët, e kanë marrë e kanë dërguar në komandën e zonë -- në komandën brigadës në Reti, Jakup Muharremin dhe atje janë marrun Sabaudin Cenaj me Skënder Hoxhën janë marrë me të.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ça doni të thoni që "Sabaudin Cenaj dhe Skënder Hoxha u morën me të", ça doni të thoni me këtë?

PË. Sipas Jakupit, siç e ka thënë ai dhe sigurisht i keni deklaratat edhe ju, ai ka thënë se e kanë rrahur fizikisht.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Të dy ata?

PË. Ai ka thënë të dytë. Unë nuk e di. Unë s'kam qenë aty.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dhe, së fundi, thatë që Tahir Sinani me cilësinë e tij si komandant zone, iu dha paralajmërim, qortim pra, Skënder Hoxhës, kështu?

PË. Po e kam mësu më vonë, që Tahir Sinani i kish dhënë vërejtje Skënder Hoxhës dhe kish thënë mos të ndodhin raste të tilla se të shkarkoj. Dhe Tahir Sinani ka qenë komandant i zonës kuptohet. Këtë e kam marrë shumë vonë vesh, domethënë, pas lufte. Unë nuk kam ditë asgjë sepse ndoshta do të isha revoltu dhe ma shumë gjatë asaj kohe, unë Jakup Muharremin e

kam familjar.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po pse z. Sinani ia lëshoi këtë vërejtje? Cila ishte arsyeja? Ishte për ndalimin e z. Muharremi apo për keqtrajtimin e tij?

PË. Po s'e unë. Nuk e di saktësisht. Sigurisht për të dyjat.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më datë 15 nëntor 2023, i keni thënë z. Emmerson, Mbrojtësit të Veselit, që Halil Qadraku u bë shef i ZKZ, pra, i zbulim kundërzbulimit në vitin 1999 dhe z. Qadraku kishte mbërritur disa ditë përpara komandant Drinit i cili hyri në Kosovë në 16 dhjetor 1998. Ju kujtohet që e keni thënë këtë?

PË. Po, kështu kam thënë. Kështu kam thënë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kisha fjalën për faqen 10158, rreshtat 4 deri në 6 dhe 23, 24.

Pyetja ime është kjo, z Qadraku çfarë bëri nga momenti i mbërritjes në Kosovë në dhjetor 1998 dhe deri në emërimin e tij si shef i ZKZ-së në zonën operative të Pashtrikut në vitin 1999? Cilat funksione i kishte gjatë kësaj periudhe?

PË. Në atë kohë ka qenë zona akoma e pakompletume. Bile dhe disa brigada kanë qenë në konsolidim e sipër në strukturat e tyre. Z. Qadraku ka qenë në Brigadën 124 dhe sigurisht ka pritë Drinin derisa të kthehet për ta marrë emërimin dhe për të bashkëpunuar. Kështu ka qenë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar. Gjithashtu, i thatë z. Emmerson se u pajtuat me përshkrimin që

z. Qadraku i kishte dhënë ZPS-së se i duhej që të fillonte ngritjen e strukturave të zbulimit-kundërzbulimit gjatë periudhës të janarit të vitit 1999. E kam fjalën për faqen 10159 të transkriptit, rreshtat 3 deri në 8.

Cili apo cilat institucione i përmbushnin funksionet e zbulim kundërzbulimit në këtë zonë në atë zonë që më vonë u quajt zona operative e Pashtrikut përpara janarit të vitit 1999?

PË. Para janarit nuk ka pasë zbulim kundërzbulim. Nuk ka qenë e organizume kjo strukturë. Sigurisht ushtarët kanë bë veprime të tillë me e zbulu armikun, ata kanë qenë ekipe vëzhguese, togje vëzhguese, skuadra vëzhguese. Dhe këta kanë bë vëzhgimin e armiqve. Pas janarit ka fillu kjo, sistemi, formimi i strukturës zbulim kundërzbulimit. Halil Qsadraku ka qenë i vetëm, vetëm si person ka qenë i emërum, pastaj ka vazhdue.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kush apo cilat institucione mblidhnin informacione për njerëzit që bashkëpunonin me armikun, nëse kishte një institucion të tillë apo nëse kishte njerëz të tillë të cilët i mblidhnin këto informata?

PË. Zakonisht deri atëherë ka ndërhye në këshillat e fshatrave njerëzit civil. Dikush ka pasë për qëllim hakmarrje, dikush kundërvënie. Kështu që kanë ardhë me informacione të tilla se ky është bashkëpunëtor, ai ka qenë bashkëpunëtor, që nuk kanë pasë relevancë për neve. Nuk kanë pasë relevancë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dëshmitar, ju po kështu i

konfirmuat Mbrojtjes së Veselit se nga qershori deri në nëntor të 1998, ku ishit komandant i Batalionit Budakovë, askush nuk ushtronte funksione të policisë ushtarake. Kjo është në faqen 10159 të transkriptit, rreshtat 16 deri në 21.

Për të qenë të qartë për këtë, mos po thoni se s'ka pasur polici ushtarake në të gjithë atë zonë, e cila më vonë u bë zona operative e Pashtrikut dhe askush tjetër nuk ushtronte funksionet e policisë ushtarake?

PË. Nuk e di sa i përket zonave të tjera dhe njësive të tjera, nuk e di. Atëherë kam qenë komandant batalioni. Si komandant batalioni fillimisht kam nda një skuadër e cila ka qenun për intervenime të shpejta, disa djem më të zotë, disa luftëtarë më trima, ma të shpejtë, më të ushtruar. Dhe pastaj ajo skuadër është bë policia e batalionit në Budakovë. Nuk e di a ka pasë polici në struktura të tjera sepse atëherë kam qenë shumë i shkëputun, vetëm në nivelin e batalionit.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për shembull, nëse një ushtar i batalionit tuaj enkas e shkelte njërin prej urdhrave tuaj, ju vetë nuk mund t'i kërkonit dot dikujt që ta çarmatosnin dhe ta arrestonin një ushtar të tillë? Nuk është kjo njësia e veprimit të shpejtë të cilën ju e keni ngritur atëherë?

PË. Zakonisht, zakonisht për atë edhe është bë ajo njësi, për ndonjë problem kudo qoftë mes ushtarëve apo në rastet e intervenimeve të armikut. Ata të jenë prezentë që ishin më të

shpejtë, më të armatosur, më të ushtruar. Edhe në raste të veçanta ka mujt me urdhro me i thënun thirrna ushtarin, bjerna ushtarin, me i çarmatos, me i lënë disa ditë me punu punë fizike në kuzhinë apo detyrimisht me bë ndonjë veprim jashtë asaj me armë sepse ishte penalizim për në atë kohë me ia heq armën, me ia heq amblemën e UÇK-së. Nuk më ka ndodhë me ia heqë edhe uniformën me përjashtu krejt. S'më ka ndodhë asnjëherë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Sipas rreshtave në vijim në faqen 10195 deri në faqen 10260, ju thatë që diku nga fundi i marsit fillimi i prillit 1999, Nexhmi Krasniqi u emërua si shef i policisë ushtarake në zonën tuaj.

Pyetja ime është kjo, a e dini se çfarë funksionesh kishte Nexhmi Krasniqi përpara se të emërohej si shef i policisë ushtarake në zonën tuaj, ma merr mendja që ka qenë anëtar i UÇK-së në atëkohë, apo jo?

PË. Me siguri ka qenun prej fillimit në luftën e UÇK-së. E dija se ai vjen nga një fshat Tërpezë. Dhe ka qenë në njësi tjera që unë s'kam pasë kontakt gjatë luftës, po e dija që ka qenë luftëtar i mirë. Dhe kur ka ardhun në zonën operative të Pashktrikut i emëruar si komandant i kompanisë të policisë ushtarake, ai ka ardhë me tre-katër policë ushtarakë. Nuk ka pasë njësi të kompletuar.

Më vonë janë bë togjet e policisë ushtarake në nivel të

brigadave.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në të njëjtin kontekst, na thatë se ekzistonte nevoja për të pasur polici ushtarake në nivel zone, së paku nga fundi i marsit dhe prilli i 1999. Ju kujtohet që e keni thënë kështu para dy javësh?

PË. Po, po ashtu është. Ashtu kam thënë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja është kjo, po pse ekzistonte nevoja për polici ushtarake në nivel zone në mars të 1999 dhe jo përpara këtij muaji apo pas këtij muaji?

PË. Nevoja ka qenë pi fillimit t'i kem. Po s'kemi pasë struktura të tilla. Dhe mezi se kemi arrit në atë kohë. Dhe ne nuk e kemi dit sesa ka me vazhdu lufta. Çdo ushtrie i duhet një polici ushtarake, një organ disiplinor që merret me problemet ushtarake, me problemet e ushtarëve, të luftëtarëve. Kështu ka qenë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po pse ishte e nevojshme që të vendosej posti i shefit të policisë ushtarake në nivel të zonës operative për z. Nexhmi Krasniqi?

PË. Po ishte e nevojshme të krijohet hierarkia dhe te policia ushtarake. Të ketë komandant të policisë, të ketë zëvendëskomandant dhe sigurisht edhe njësitë ma të vogla, skuadrat e policisë, togu.

Kështu që Tahir Sinani ka pasë atë përgjegjësi për ta emëruar dhe për të qenë në kontakt të vazhdueshëm me raporte me policinë ushtarake përmes Nexhmedin Krasniqit.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Një sekondë, ju lutem.

A kishte polici ushtarake në nivel brigade apo batalioni përpara fundit të marsit, fillimit të prillit të vitit 1999?

PË. Jo. Përpos atë që thashë në batalionin a Budakovës, brigadat kanë fillu pas emërimit të Nexhmedin Krasniqit të krijojnë skuadrat e policisë. Kanë arrit në nivelin e togut të policisë ushtarake në nivel brigade, më vonë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dëshmitar, Trupi Gjykues ka nevojë për sqarim nga ana juaj për një pikë tjetër. Në intervistën tuaj me Prokurorinë në janar të vitit 2020, thatë se Nexhmi Krasniqi, me cilësinë e tij si shef i policisë ushtarake në zonën e Pashtrikut, i ka raportuar Tahir Sinanit si komandant i zonës operative, raportonte te ju si zëvendëskomandant i zonës operative nëse z. Sinani nuk ndodhej aty dhe pastaj drejtpërdrejt z. Fatmir Limaj, komandant i policisë ushtarake brenda Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Ju thatë në këtë kontekst dhe po ju citoj:

"Policia kishte hierarki të posaçme. Thuhet dhe në strukturë aty. Pra, që është policia ushtarake që kishte linjë të drejtpërdrejtë raportimi me shtabin deri aty lart."

Kjo është në provën materiale P707.4, faqe 1 deri në 2.

Ndërkohë, që gjatë kundrapyetjeve që ua bëri Mbrojtja e z. Selimi, që është në faqen e transkriptit 10320 dhe në vijim, ju thatë që z. Krasniqi i raportonte vetëm z. Sinani dhe në mungesë të z. Sinani, ju përgjigjej juve, raportonte

juve pra.

Pra, pyetja ime është, z. Krasniqi i raportonte vetëm komandës së zonës apo edhe Shtabit të Përgjithshëm, gjegjësisht z. Limaj, siç e keni thënë në intervistën tuaj me ZPS-në në janar 2020?

PË. Unë jam i sigurtë që ai ka raportu te Tahir Sinani. Në mungesë të Tahir Sinanit, ka mund të njoftojë dhe mu, të raportoj te unë. Për sa i përket raporteve me Shtabin e Përgjithshëm, nuk e di çfarë relacioni ka pasë dhe sa ka mund të jetë në kontakt. Për shkak se Shtabi Përgjithshëm ka qenë shumë mobil, domethënë, i lëvizshëm. Dhe në pamundësi për ta kontaktuar Shtabin e Përgjithshëm, këto raporte kanë përfundue në nivelin e komandantit të zonës deri te shefi i shtabit ndoshta me vonesë kanë arrit. Nuk e d i çfarë relacione ka pasë me Fatmir Limën.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Si ka qenë situata kur Drini ishte komandant i zonës operative? Kishte linjë të drejtpërdrejtë nga policia ushtarake apo Nexhmi Krasniqi deri tek Shtabi i Përgjithshëm, gjegjësisht z. Limaj?

PË. Nuk e di si i ka mbajtun raportet Drini me Shtabin e Përgjithshëm. Po te ne, në *briefing* [në anglisht] e kemi ditë që çdo gjë që vendoset në nivel të zonës, duhet të njoftohet edhe Shtabi i Përgjithshëm, sidomos shefi i shtabit. Drini ka pasur relacione të mira me shefin e shtabit. Ndërsa me të tjerët naltë çfarë kontakte ka pasë, nuk e di. Nuk ka pasë

nevojë të më informojë mu apo ta di edhe unë. S'kam qenë i detyru.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem vendosni provën materiale P707.4, faqen 7 që ta shohim në ekran. Versionin në anglisht duhet të mjaftojë.

Dëshmitar, do t'ju lexoj edhe se çfarë keni thënë gjatë intervistës me ZPS-në në janar 2020, ju lutem dëgjojeni me kujdes. Është në faqen 7, rreshtat 9 deri në 15.

"PY. A keni pasur takime të rregullta me komandantin e policisë ushtarake në komandën e zonës në nivel zone?"

"PË. Jo, nuk mbanim takime të rregullta sepse komandanti -- kështu pra, ata kishin në linjë të drejtpërdrejtë raportimi me qendrën, përpos rasteve kur kalonte përmes komandës së zonës së Tahirit. Siç e tregova në strukturën, tregohet aty, jepet aty. Ata i raportonin komandantit të policisë, komandantit të përgjithshëm të policisë, Fatmir Limajt".

Ju pyes përsëri: Pse keni thënë në janar të vitit 2020 se kishte linjë të drejtpërdrejtë raportimi mes Shtabit Përgjithshëm dhe z. Limaj?

PË. Nuk është korrekt. Është e gabueshme nëse kam thënë janar. Mund të jetë nga fundi i marsit po realisht u dashtë të jetë ashtu që të raportohej policia në nivel qendror, po nuk ka funksionuar për shkak të mungesës së prezencës së njerëzve të Shtabit të Përgjithshëm. Kam thënë se u kanë dashtë t'i raportoj Limës, se s'kam qenë unë me faktu me fakte se a ka

raportu me pasë ndonjë raport në dorë.

Nuk kam pasë ndonjë raport konkret që ka dërgue atje, po kam thënë se u dashtë t'i raportoj komandant Limës. Po jo asisi në asnjë mënyrë në janar. S'ka qenë Nexhmedini në janar.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dëshmitar, tani për një temë tjetër. Gjatë pyetjeve që ua bëri Avokati i Veselit, ju folët për drejtoritë e ndryshme në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së dhe në këtë kontekst keni thënë se, për shembull, ata pak njerëz që punonin në drejtorinë politike mund të mos i kishin ditur detyrat e një drejtorie tjetër. Dhe ju vijuat të thoni kështu:

"Komandanti i brigadës nuk e dinte se çfarë ndodhte në një brigadë tjetër se nuk mbanim dot raporte të ngushta. Kjo do të thotë që dikush nuk mund t'i dinte se çfarë bëhej në një drejtori tjetër".

Pyetja ime është kjo, dëshmia juaj është kjo që nuk kishte kontakte midis brigadave, nuk bëheshin mbledhje ndërmjet komandantëve të zonave, s'kishte asnjë komunikim ndërlidhje, pra dhe nuk kishte asnjë komunikim, asnjë kontakt midis shefave të drejtorive të ndryshme në nivel të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?

PË. Z. Gjykatës, këtë e kam thënun që nuk ka funksionu në mënyrë horizontale urdhrat dhe bashkëpunimi i drejtpërdrejtë. Ka funksionuar në mënyrë vertikale, në këtë kuptim e kam thënë. Se komandantët e brigadave nuk kanë pasë lidhje

horizontale ose ndikim njëni mbi tjetrin ose urdhra njëri mbi tjetrin. Por ata janë kanë të drejtuar në nivel të zonës. Zona në briefingjet e veta ka mare vendime dhe ka njoftu shefin e shtabit, shefin e Shtabit të Përgjithshëm. Kështu ka qenë.

Edhe drejtoritë që kanë qenë aty në organogramë timin që janë një e dy, e tre, nuk kanë pasë ndikim njëra te tjetra. Dhe s'kanë pasë, ato duhet të jenë horizontalisht të vizatuara, të formatizuara dhe horizontalisht nuk kanë pasë ndikim njëna mbi tjetrën. Përpos që kanë pasë ndikim drejtpërdrejt me komandantin e Shtabit të Përgjithshëm. Kështu ka qenë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, me cilësinë tuaj si zëvendëskomandant i zonës operative, a komunikonit apo nuk komunikonit, bashkërendonit apo nuk bashkërendonit me zëvendëskomandantë të zonave të tjera operative?

PË. Me zona të tjera operative nuk kena pasë as bashkërendim, as raporte. Kena pasë raste kur kemi dërgue ushtarë në ndihmë për luftën në rastet e sulmeve të armikut. Kena çu ndihmesë në zonën e Dukagjinit, në zonën e Shalës. Mirëpo nuk kemi pasë ndikim as interferim në mes zonave, prej zonës së Pashtrikut me interferu në zona tjera.

Ndërsa me brigadat e zonës operative të Pashtrikut ka qenë gjithçka në vijën hierarkike komanduese nga momenti kur caktohem unë zëvendëskomandant i kësaj zone dhe Tahir Sinani komandant.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nga e dinit ju që nevojitej ndihmë në një zonë tjetër operative?

PË. Ishin dy mënyrat e komunikimit. Kërkesa nëpërmes korrierëve dhe kërkesa me radiolidhje. Dikur vonë kemi pasë edhe telefon satelitor. Përmes këtyre lidhjeve ne kemi dërgu ndihmesa. Kemi dërgu dhe miell për civilët, për ushtarët. Kemi dërgu njësite të caktuara për të ndihmuar operacionet luftarake.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju kujtohet kur keni marrë këto telefonat satelitorë? Në cilin muaj?

PË. Saktësisht nuk e di. E di që dikund ka fundi i marsit apo fillimi i prillit. Saktësisht nuk e di. I di rastet kur kemi çu ndihma, për shembull, për Dukagjin, di datat kur kemi shku me intervenu me bashkëvepru në luftë kundër armikut bashkarisht. E këto telefonat kur kanë ardhë nuk e saktësisht datën. Po e di që në fund marsit ose në fillim të prillit.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në vitin 1999?

PË. Po, po, në 1999.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

Dëshmitar, juve na thatë se nga dhjetori i vitit 1998 deri në 15 janar të 1999, ishit i vendosur brenda Shtabit të Përgjithshëm në atë muaj. Thatë që nuk ishit gjithë kohës aty sepse duhet të merrnit pjesë dhe në luftë për të shpëtu popullatën dhe keni luftuar për katër ditë e gjysëm. E kam fjalën për faqen 10401 të transkriptit, rreshti 11 deri në 20.

Po kështu ju konfirmuat, pak më poshtë, kur ju përgjigjët Prokurorisë, që ju mendoni se z. Veseli nuk ka qenë në Kosovë nga fillimi i janarit 1999 dhe më vonë atij viti, domethënë, në prill të 1999, kur e keni shpënë me automjet në fshatrat përkatëse më saktë.

Tani pyetja ime është kjo, përse mendoni që z. Veseli nuk ndodhej në Kosovë gjatë kësaj kohe? Është vetëm nga që ju nuk e keni parë në shtab? E bëj këtë pyetje sepse ju nuk ishit në shtab gjithë kohës, siç e keni thënë vetë, apo jo?

PË. Realisht është ashtu. Unë kam thënë se kam qenë nga mesi i dhjetorit deri më 15 janar kur është bë bëtaja e Reçakut. Në masakrën e Reçakut kam shku me koordinu luftën mes forcave të batalionit të dytë të Budakovës dhe zonës së Nerodimës për me i mbrojt popullatën e Reçakut dhe me i mbrojt kufomat.

Pasi jam kthy prej atijit jam kthy edhe njëherë në Shtabin e Përgjithshëm. Kështu që gjatë krejt kësaj kohe nuk e kam pa askund z. Veseli. Dhe kam ardhë në përfundim se ai a dikund jashtë, jashtë Kosovës.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptova. Për procesverbalin, ku ndodhej saktësisht, pra, komanda e Shtabit të Përgjithshëm aso kohe? Në cilin vend? Në Kleçkë? E kam fjalën për dhjetorin e 1998 dhe janarin e 1999, kur ju ndodheshit aty.

PË. Po. Atëherë ka qenun shtabi në Kleçkë. Selia e shtabit.

Se anëtarët e shtabit nuk kanë qenë. Po kanë lëvizë gjithmonë, ka qenë në Divjakë, në Nishor, në Kleçkë, në vende të ndryshme. Dikund ma shumë se dhjetë vende ka lëvizë Shtabi i Përgjithshëm.

Po në atë kohë u kanë dashtë të jetë në Kleçkë, nuk ishte aty. Nuk ishin personat. Isha unë. Ishin disa teknikë që punonin me kompjuterë, disa roje. Kështu.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Keni parë edhe anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm në komandë të këtij shtabi, pra, në seli, siç e thatë, apo gjetkë në dhjetor të 1998 dhe janar të 1999? Ju më duket se thatë që shkurtimisht u takuat me Adem Grabovcin përpara se të largohej, kështu?

PË. Aty jam taku me Adem Grabovcin. Ai ka qenë shefi i J1 dhe ai ma ka lënë detyrën sepse dhe ai ka shku jashtë dikun.

Ndërkohë, më 15 janar, kur ka shpërthye ofensiva serbe në Prekaz, unë kam gjet në drejtori operative shefin e shtabit Bislim Zyrapin. Nuk e di dhe dy të tjerë kanë qenë aty, s'më kujtohen. Dhe e kam kërkuar që t'i ndihmojmë forcave tona prej anës tonë, anës së kundërt mbrapa armikut. Ai më ka thënë, "Nëse je në gjendje ti fizikisht" pasi që unë isha akoma me plagë "mund të shkosh atje sepse ki ndikim te ushtarët e Budakovës dhe ki lidhje me Nerodimën, me zonën e Nerodimës t'i mobilizosh ata ta organizoni Mbrojtjen". Dhe unë kam shku si mbas porosisë apo si mbas urdhrit të Bislim Zyrapit në luftën e Reçakut. Të tjerë nuk kam pa. Të tjerë nuk kam pa në shtab.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mbaheshin takime të rregullta një herë në javë apo dy herë në javë në seli të shtabit apo nuk zhvilloheshin takime të tilla gjatë kësaj kohe, pra, gjatë dhjetorit 1998 dhe janarit të 1999?

PË. Gjatë asaj kohe nuk ka pasë ndonjë takim. Gjatë asaj kohe kam takue gjatë udhëtimit në Lladrovc, Adem Demaçin. Ishte ngrica. Dhe kishte një makinë, një xhip dhe unë u afrova për t'ia shkun akullin xhipit, xhipi më foli në anglisht. Tha mos më prek. Dhe unë kur e takova bacën Adem i thashë "E ke mësu dhe xhipin të flasë, baca Adem? Mësona dhe neve më shumë". Bëmë një shaka.

Dhe kemi nej aty ma shumë se një orë, kemi bisedu për luftën, për politikat e luftës, për zhvillimet e mëtutjeshme. Për ndryshe nuk ka pasë mbledhje të Shtabit të Përgjithshëm gjatë asaj kohe.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E patë apo u takuat me z. Demaçi në Kleçkë gjatë asaj kohe? Pra, e keni pa?

PË. Në Lladrovc jam taku, më poshtë se Kleçka. Jo në Kleçkë. E kam pa e jam taku.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dëshmitar, juve përmendët gjithashtu se z. Veseli u kthye nga Rambujeja apo Shqipëria dhe erdhi në zonën tuaj operative në Nishor ku bëtë një bashkëbisedim me të dhe z. Veseli ju tha juve që donte që të shkonte në fshatra më të thella dhe ju mori në kerrin e tij edhe -- ju e morët në kerrin tuaj dhe e shoqëruat. Kjo është

në faqen 10128 të transkriptit. Ju kujtohet që e keni thënë këtë?

PË. Ashtu është. Ashtu është.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju faleminderit. Z. Veseli a ju tregoi se nga erdhi, domethënë, erdhi nga Rambujeja apo nga Shqipëria apo nga ndonjë vend tjetër?

PË. Me të thënë të drejtën, a konkluzioni jem që erdhi nga Rambujeja. Po nuk e di. Ai prej Shqipërie sigurisht ka depërtu nëpërmes Shqipërie dhe nuk e kemi fol shumë në detaje rrugën e ardhjes. Ma tepër kemi fol rreth asaj sa kemi të plagosur, çfarë gjendje kem të ushtarëve, civilët ku janë të strehum, a ke municion. Këto biseda kanë qenë me z. Veseli.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, në fakt, ju nuk e dini nëse kishte qenë në Kosovë përpara apo se nga vinte apo se vinte nga Rambujeja apo na Shqipëria apo nga gjetkë?

PË. Faktikisht unë jam kanë i bindur që ai deri në atë kohë nuk ka qenë në Kosovë edhe ka ardhë nga jashtë atë kohë. dhe sigurisht, zona jeme, zona operative e Pashtrikut kufizohej me Shqipërinë. Dhe kalimi i tij përmes Shqipërisë u dashtë me ardhë te zona, përndryshe s'ka pasë nevojë ai me zbrit në zonën operative të Pashtrikut. Në këtë kuptim, unë kam nxjerrë konkluzion që ai ka ardhë nga jashtë. A ka ardhë nga Shqipëria apo Rambuje, nuk e di.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Veseli, ju tregoi se çfarë donte të bënte në atë fshatra të thella?

PË. Jo. Jo. Përkundrazi, veç më ka kërkue që ta dërgojë deri diku deri në Divjakë apo në Tërpezë. Dhe unë e kam çu deri aty ku ka kërku ai me makinën time, me shoqëruesin tonë, shoferin dhe jam kthy prapë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk ju interesonte që ta mësonit se çfarë donte të bënte aty?

PË. E kisha përshtypjen që ai e din më mirë se unë. Sigurisht kish kërku ndihmesën teme në kuadër të zonës po, më përtej ...

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju kuptoj.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dëshmitar, vazhdoj tek pyetja e radhës. Kur Ekipi i Mbrojtjes ju parashtroi se z. Veseli nuk ka qenë personi i vetëm me nofkë Luli, ju jeni përgjigjur në transkript në faqen 10182, si në vijim:

"Ka pasur shumë nofka me dhjetëra Luli, Guri dhe shumë e shumë të tjerë".

Trupi Gjykues dëshiron të dijë, kush e thërriste tjetër atë Luli? Kush janë këta personat e tjerë që kanë pasur të njëjtë nofkë gjatë luftës? A mund të na jeni emrin apo emrat e këtyre personave që kanë mbajtur të njëjtën nofkë?

PË. Unë nuk e di me të njëjtën nofkë që mujt t'ia jap ndonjë emër. Po ka pasë edhe në zonë të Pashtrikut, edhe në Drenicë me pseudonimin Luli, me nofkën Luli. E di kush ka qenë Guri me nofkën, Graniti. Unë për veten time as nuk kam pasë nofkë, as nuk kam pasë maskë. Kam qenë kështu me emën mbiemër. Nuk e di

realisht emnat nuk ua di se ka qenë vështirë, nofkën e din po emnin s'e dinë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, që ta kuptoj siç duhet, ju nuk i referoheshit ndonjë personi konkret kur keni thënë ka pasë dhe Luli të tjerë, nuk keni pasë ndonjë person konkret në mendje?

PË. Jo, nuk kam pasë person konkret, po kam pasë njohuri se është kanë Luli, Luli, është përmend gjithmonë nga ushtarë tjerë te Luli, prej Lulit. Domethënë, në zonën time ka pasë Luli, ndihej ma shumë. Plus ka pasë edhe në zona tjera me pseudonimin e njëjtë Luli.

E tash nuk e kam e ditë unë se Kadri Veseli e ka pseudonimin Luli. Po e kam dit Kadri Veseli, kur ka ardhë te unë, sepse mixhën e Kadri Veselit e kam pasë shok në Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës, Sabit Veselin. Sabiti ka qenë herët i organizum. Atë e kam njoftë. Dhe si ma ka thënë mbiemnin Veseli e kam pasë një konsideratë të veçantë. Kam mëndu që është vëllai i Sabit Veselit.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull. Bëjmë një shkëputje të shkurtër në mënyrë që Gjykatësi Gaynor të hyjë dhe të dalë sërish nga videolidhja.

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jam sërish në videolidhje.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na shihni, Gjykatësi Gaynor?

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po, ju shoh dhe ju dëgjoj. Faleminderit. Dhe vazhdoni.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet. Mund të rishikoni edhe njëherë disa nga përgjigjet që dha dëshmitari se patët një shkëputje. Ka pasë një pyetje në rreshtin 20 të transkriptit. Ju këshilloj që ta shihni gjatë kohës që nuk keni qenë i lidhur.

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Në rregull. Po, do ta shoh pyetjen dhe përgjigjen.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, po ju japim një minutë që ta bëni tani.

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Në rregull. E lexova.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, Gjykatësi Barthe.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dëshmitar, jeni në dijeni ju të faktit që ka pasur një person tjetër në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së që ka pasur pseudonimin Luli në atë kohë? Konkretisht, bëhet fjalë për periudhën 1998 dhe 1999.

PË. Nuk jam i sigurtë që ka pasë pseudonim Luli në Shtabin e Përgjithshëm, po tani jam i vetëdijshëm se Kadri Veseli e ka pasë pseudonimin Luli. Për të tjerë në shtab s'kam njoft Luli. As e kam ditë që janë të shtabit. Përndryshe me pseudonimin Luli vërtetë ka pasë në shumë vende, në shumë struktura.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Po ashtu gjatë

kundërpyetjeve, pak më vonë, ju u pajtuat tërësisht me Mbrojtjen e z. Veseli që zona të tjera operative ka qenë më kaotike situata, ka qenë më kaos situata. Dhe kjo është e reflektuar në faqet 10191 të transkriptit, rreshtat 20 deri në 24.

Pyetja ime është kjo, nga e dini ju që në zonat e tjera operative ka qenë më kaotike situata? Bisedonit me komandantët apo zëvendëskomandantët e zonave të tjera operative për situatën? Se ju besoj që keni thënë pak më herët që komunikonin zonat e ndryshme operative me njëra-tjetrën, kështu?

PË. Është mendimi im edhe atëherë edhe tash, se ka qenun gjendja ma e keqe, s'po du me thënë krejt kaotike, për shkak se ne jemi detyru t'ju çojmë ndihma edhe me luftëtarë, edhe me armë, edhe me miell. Ne i kemi mbajt me miell zonën e Dukagjinit, zonën e Drenicës, njëkohësisht kemi çu në ndihmesë luftëtarët tanë me u përballë me betejat në Dukagjin dhe në Shalë.

Tu e ditë se ata kishin nevojë për ndihmesën tonë vazhdimisht, kam ardhë në konstatim se ata janë kanë qenë në gjendje ma të keqe dhe më pak të organizuar.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Në fakt, ju pyeta për këtë se Trupi Gjykues dëshironte të dinte pse e keni thënë diçka të tillë, pra, baza, deshëm të dinim nga ku e bazonit njohurinë tuaj në lidhje me këtë. Por tani e kemi të

qartë.

Pyetja e radhës ka të bëjë me një dokument që quhet "Rregullorja e Disiplinës e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Prishtinë 1998". Gjykatësi Mettraux do të ketë më shumë pyetje për këtë dokument, që mban numrin e provës materiale P715. Unë kam një pyetje tani, ju po thoni që ky dokument është përpiluar prej jush, Nuredin Abazit dhe Halil Qadrakut në mars ose në prill të 1999 në laptopin e zonës suaj operative dhe më pas ju dërgua UÇK-së apo z. Demaçi, ku dikush tjetër pastaj i vuri dokumentit vitin 1998? Këtë po thoni? A është ky mendimi juaj?

PË. Mendimi jem ishte dhe veprimtaria jonë ka qenë në ato parime që thatë ju, por sa i përket kësaj rregullore, kjo rregullore ishte kopjuar nga rregulloret e Shqipërisë. Dhe ishte e nënshkruar nga Fehmi Baftiu, se atë ditë e pashë nënshkrimin, po nuk mujsha të futem në bisedime për shkak të dinamikës të bisedave. Fehmi Baftiu ka qenë një jurist me përvojë. I cili e ka përpunu këtë, i ka dhënë disa materiale të UÇK-së, e shumica e saj ishte rregullore e Shqipërisë.

Kjo është punu në zyrën e Adem Demaçit në Prishtinë. Dhe nuk kam mbërri asnjëherë në dorën time. Ne kemi pasë rregullore tona. Unë mendova që a rregullore e zonës. Ne kemi bë rregullore të zonës me Nuredin Abazin e me shokët aty në zonë, me njerëzit e stafit të zonës. Mirëpo këtë rregullore, ndoshta është marrë ndonjë material i jonë atje, është marrë

ndonjë material i jonë, por rregullorja është krye këput e kopjume nga rregulloret e Shqipërisë dhe asnjëherë s'ka ardhë te unë në dorën time në zonë. Tani e kam pa këtu.

Kur ma tregoi Avokati Emmerson, unë mendova që a një nga ato rregulloret e zonës, kanë qenë dy apo tri rregullore në zonë që i kemi përpilu na, e vetëm janë botu në Prishtinë. Kjo ishte përpilu dhe botu në Prishtinë. Ndoshta është marrë ndonjë element i joni i UÇK-së, po kryesisht ishte me *copy-paste* [në anglisht] të rregulloreve të Shqipërisë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Besoj se do të trajtohet dhe më vonë kjo temë gjatë ditës së sotme.

Më 15 nëntor 2023, ju na thatë që Halil Qadraku, si shef i ZKZ-së apo G2 në zonën operative të Pashtrikut, i raportonte Tahir Sinanit që ishte komandanti i zonës operative ose Bislim Zyrapit si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së të paktën deri në prill të q 1999, kur z. Zyrapi edhe zëvendësohet nga Agim Çeku. Kjo është në faqen 10209 të transkriptit. Ju thatë që ju besoni që z. Qadraku nuk i raportonte z. Kadri Veseli sepse nuk ishte e mundshme për Qadrakun të takohej me z. Veseli sepse z. Veseli nuk ka qenë në Kosovë deri në prill të 1999, kështu?

PË. Kjo në fund është krejt e vërtetë. Ndërsa fillimi i bisedës së juaj, ku thotë prej 15 dhjetorit, nuk ka pasë ZKZ më 15 dhjetor, domethënë, Halil Qadraku u emëru në janar, jo në dhjetor të 1998. Ju kisha lut ta korrigjoni, z. Gjykatës. E

krejt tjetër biseda është tamam ashtu si e thatë ju.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Jo. Por ju e keni përfshirë z. Veseli si shefin e zbulimit dhe kundërzbulimit ose G2 në organigramën e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në faqen 8 të librit tuaj, a është kështu?

PË. Po. Po, është ashtu. E vërtetë është kjo. Vetëm data që thatë se e ka raportu prej 15 dhjetorit 1998 nuk koinçidon me kohën, vetëm kjo.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Si shefi i zbulimit dhe kundërzbulimit i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, z. Veseli a e vizitonte rregullisht brigadat dhe komandën në zonën tuaj operative gjatë kohës që ishte ende në Kosovë, dini gjë për këtë?

PË. Jo, nuk kam rastis të takohem asnjëherë në nivel zone, as nivel të njësive më të ulëta. Ndoshta ai i ka vizitu, po unë nuk e di. Nuk kam njohuri.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ai nuk ju ka vizituar ju --

PË. Jo, jo.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] -- gjatë kohës që keni qenë ju zëvendëskomandant?

PË. Nuk e kam taku. Nuk e kam taku.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja e radhës ka të bëjë me një nga përgjigjet që i keni dhënë Mbrojtjes së Thaçit gjatë kundërpyetjeve që u bënë më 16 nëntor 2013, ju thatë se e morët ju komandën e zonës operative të Pashtrikut pasi u

largua komandant Drini për t'u bërë shefi akademisë ushtarake dhe zëvendësi i tij me emrin Sulejman Kollqaku u largua, e braktisi detyrën pra. Kjo është e reflektuar në faqen 10249 të transkriptit.

Dëshmitar, ju na thatë që komandant Drini u emërua, domethënë, më 15 dhjetor, pra dhe njëherë. Komandant Drinin e ka zëvendësuar z. Sinani më 17 mars 1999? Ju kërkoj ndjesë, këtë doja të thoja.

PË. Po, është kështu.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kisha fjalën për faqen 10173 të transkriptit, rreshtat 6 dhe 10 ku është reflektuar kjo.

Kam një pyetje, komandant Drini saktësisht kur u largua për t'u bërë kreu apo drejtuesi i akademisë ushtarake, nëse e dini?

PË. Mendoj diku në fillim të marsit. Në fillim të marsit ka shkue, është emëruar në Shtabin e Përgjithshëm për akademinë ushtarake. Ndërsa nga fundi i shkurtit, ka munguar Sulejman Kollqaku, i cili ka dezertuar. Ka ikur. Kështu që ka mbetun vakant. Ka mbet vakant niveli i zonës, na kemi bë luftime dhe pa ata.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju morët përsipër komandën e zonës operative në fund të shkurtit, fillim i marsit 1999, kështu, derisa erdhi z. Sinani, kështu?

PË. Unë në atë mënyrë sjellun. Përndryshe, asnjëherë s'e kam

quajt veten komandant i zonës. Edhe tash e 23 vite e mungon Tahir Sinani a i vdekur, unë s'kam thënë kurrë që kam qenë komandant i zonës. Por detyrimisht jemi detyru të përballemi me betejat dhe e kam luajt atë rol.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, që ta kuptoj unë siç duhet, në kohën që z. Qadraku dhe ju personalisht i shkruajtët letrën Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së ku ankoheshit për komandant Drinin, kjo është prov materiale P500, kjo ishte më 14 mars 1999 edhe Drini tashmë ishte larguar nga pozita e tij si komandant i zonës operative të Pashtrikut dhe kishte marrë detyrën e re si kreu i akademisë ushtarake, kështu?

PË. Ne nuk e dinim akoma a ishte emëruar a s'ishte i emëruar. Ne e dinim që mungonte. Mungonte dhe raporti në zonë, mungonte raporti prej brigadave dhe mungonte Drini, mungonte dhe Sulejman Kollqaku. Dhe kjo letër u bë për të vu rregull, për të krijuar norma dhe raporte me zonat e me njësitë vartëse. Kështu ka qenë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Besoj se e kuptoj tani, e kam më të qartë. Faleminderit.

Vazhdojmë me një temë tjetër. Sërish nga kundërpyetjet e Mbrojtjes së Thaçit, ju thatë që drejtoria politike që drejtohet nga z. Thaçi nuk ishte në nivelin që do kishit dëshiruar ju apo siç do duhej për luftën sepse kishte si personel vetëm z. Thaçi dhe dy a tri persona të tjerë. Kjo është e reflektuar në faqen 10273, rreshtat 9 dhe 15 dhe faqen

10278, rreshtat 2 dhe 3 të transkriptit.

Dëshmitar, pyetja është kjo, nga e dini ju që drejtoria politike kishte si personel vetëm z. Thaçi dhe dy a tri persona të tjerë? E keni takuar ju z. Thaçi gjatë kohës që keni qenë në Shtabin e Përgjithshëm në Kleçkë në dhjetor të 1998 apo janar të 1999?

PË. Jo, nuk është fjala për dhjetor 1998, janar 1999. Po unë e kam taku z. Thaçi në korrik të 1998 dhe ashtu ka qenë me dy-tre ushtarë apo kanë qenë stafi i tij, nuk e kuptoj. Ka qenë një vizitë në batalionin e Butakovës. Në kohën e dhjetor, janar, dhjetor 1998 dhe janar 1999, nuk e kam taku unë në Shtabin e Përgjithshëm z. Thaçi. E kam taku një rast. Nuk e di data sa ka qenun. Rastësisht kam shku për të marr municion në Kleçkë, mos gjej dikund ndonjë magazinën qendrore dhe e kam pa duke la fytyrën para Shtabit të Përgjithshëm në mëngjesin e hershëm. Thotë "Çka ke ardhë këtu?". Them "Kam ardhë të kërkoj municion se ka mundësi të kemi beteja". Thotë "Nëse ke sot ndonjë betejë po vij edhe unë në betejë". Thashë "Jo, jo. Sot jo po pritet këto dy-tri ditë". Kaq e kam taku.

S'e kam pa më z. Thaçi, dy herë krejt gjatë luftës.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Gjatë kohës kur ishit i vendosur në Shtabin e Përgjithshëm në Kleçkë, dhjetorin 1998 dhe janari i 1999, a keni parë ndonjë zyrë apo më saktë, a jeni takuar dhe keni biseduar me punonjës të z. Thaçi?

PË. Jo. Jo, jo.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më korrigjoni nëse e kam gabim, po ju nuk mund ta thoni me siguri sa veta punonin për z. Thaçi, nuk e dini me siguri sa persona në drejtorinë politike që të punonin me z. Thaçi të paktën këtë s'e keni ditur deri më qershor apo më korrik të 1998, a është kështu?

PË. Kështu është. Perceptimi im ishte ai, ju keni të drejtë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ishte opinioni juaj, po?

PË. Opinioni jem.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj këtë gjë. Po ashtu thatë se nuk e dinit ku ishte z. Thaçi nga mesi i nëntorit të 1998 deri në shkurt të 1999 dhe thatë se kjo ishte para Rambujesë si periudhë, ju thatë që nuk e dini, a ishte në Kosovë, a ishte në Shqipëri, a ishte gjetkë? Dhe nuk e dinit se çfarë po bënte, kështu?

PË. Po.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, periudha mesi i nëntorit edhe shkurti?

PË. Korrekt është. Korrekt. Kështu është.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kur konfirmuat një sugjerim të z. Kehoe kur tha që z. Thaçi nuk mund të jepte urdhra për askënd, përveçse për vartësit e vetë edhe, në këtë rast kur e pohuat ishte opinioni juaj, sepse ju as e keni takuar as e keni parë, kështu, gjatë asaj kohe?

PË. Shumë keni të drejtë. Unë them për veten time. Dhe për

nivel të zonës s'na ka ardhë ndonjë urdhër. S'muj me ditë për të gjitha të tjerat. Por në bazë të detyrave që duhet të kishte ai, nuk ishte urdhërdhënës.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, me fjalë të tjera, ai mund t'ju jepte urdhra edhe më shumë se dy a tri personave pa pasur ju dijeni për këtë, ju s'e dini kështu?

PË. Unë nuk jam në dijeni. Unë nuk jam në dijeni.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Jo. Dëshmitar, po ashtu në faqen 10259, rreshtat 14, 16 të transkriptit thatë se keni dashtë ta takoni z. Thaçi pas luftës por nuk mundët. Dhe meqë nuk e pyesim dot z. Thaçi, po ju pyesim ju, pse nuk e takuat dot dhe pse deshët ta takonit? Çfarë arsye kishit pse dëshironit ta takonit z. Thaçi pas lufte?

PË. Unë pas lufte kam qenun tri vite në TMK. Pastaj tri vite të tjera kam qenë kryetari i veteranëve të luftës të UÇK-së. Dhe kam pasë nevojë me siguri me e taku shumë herë, jo një herë. Po asnjëherë s'kam arrit ta takoj për shkak se këta që bëhen të mëdhej, bëhen ministra, kryeministra, presidenta mbajnë shumë telefona dy-tre telefona, shumë shoqërues, dy-tre shoqërues. I thua njënit ta takoj. Thotë "Po, po i them". I thua tjetrit, "Po, po i them". Edhe kështu që nuk i thotë hiç ose i thotë edhe ai thotë nuk kam kohë ta takoj dhe asnjëherë qasje s'kam pasë.

Edhe për atë nuk i jam mirënjohës fare. Por jam shumë i hidhërum pse s'më ka takuar asnjëherë. Nuk e di ça ka pasë.

Ndoshta ai mund të ketë diçka me mu. Unë s'kam pasë asgjë të keqe më të. S'ka dashtë me më taku me siguri. Është krejt punë e tina. Jo korrekte.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja e radhës ka të bëjë me një përgjigje që i keni dhënë Mbrojtjes së Selimit kur po flini për z. Holbrooke, vizitën që ka bërë ai në qershor të 1998 në Junik. Ju thatë:

"Shkurtimisht pas mbërritjes sime, ai", z. Holbrooke, "ishte në Junik ku u takua me Hajredin Abazin [sipas përkthimit] dhe tha se kishte një qendër të komandës, kishte uniforma, simbole, emblema, armë dhe kishte një zinxhir komandues dhe kishte një strukturë të organizuar. Dhe që në vijim" UÇK-ja "nuk njihej më si grup terrorist po filloi të njihej si një organizatë e ushtrisë çlirimtare, si ushtri çlirimtare".

Dëshmitar, po thoni ju që në qershor të 1998, UÇK-ja nuk kishte uniforma, emblema, simbole, armë apo një strukturë komanduese apo të ishte një strukturë e organizuar? Edhe ishte kjo e gjitha sa për sy e faqe që z. Selimi quhej si personi përgjegjës për marrëdhëniet publike që të bindeshin Shtetet e Bashkuara të Amerikës apo shtetet e tjera aleate të ndërhynin nga pikëpamja ushtarake? Pra, këtë po thoni që e kishin bërë sa për sy e faqe që të dukej se kishte një strukturë?

PË. Jo, nuk është kështu. Në fillim korrigjoni Hajdin Abazi, jo Hajredin Abazi, me nofkën Lum Haxhiu. Gabim ndoshta e

lexuat ju. Dhe atje ka gjet vërtetë ai një strukturë të organizume mirë në Junik. Kanë pasë edhe armë edhe emblemë edhe uniformë. Sepse ka qenë shumë afër Shqipërisë Juniku dhe ajo pjesë ka qenë më e furnizume me armë dhe me uniforma.

Kështu që në atë komandë është gjet taman një rregull, një organizim, rojat në nivel, raportet në nivel, struktura në nivel dhe bisedat që janë bë janë kanë të nivelit. Këtë krejt e kam mësu pastaj kur ka ardhun në zonën time Hajdin Abazi më ka shpjegu sesi ka shku rrjedha. Dhe nga ai moment, është konstatuar se ka një organizatë çlirimtare, se ka një ushtri vullnetare që ka rregulla, disiplinë, ka norma, ka uniformë, ka amblemë, ka armë, ka komandë. Dhe në bazë të kësaj, është quajtun Ushtri Çlirimtare e Kosovës.

Se fillimisht, serbët janë përpjekë të na quajnë si konflikt fetar, si islamik, ma vonë si terrorist e kështu me radhë, deri në këtë kohë, domethënë, nuk e ka marrë emrin e vërtetë Ushtria Çlirimtare e Kosovës nga ndërkombëtarët. Këtë e kam thënë edhe besoj krejt pjesa tjetër ishe e saktë përpos që jemi kamuflu me uniforma veç për qatë moment nuk ekziston.

Ekziston që ka pasë uniforma dhe emri që ishte gabim i Hajdin Abazit, krejt është okei.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Më jepni një sekondë.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dëshmitar, e njëjta pyetje

si dhe më herët sa i takon z. Thaçi. Ju thatë se z. Selimi ishte një gjeneral i respektuar i UÇK-së dhe vetëm dy -- inspektor i përgjithshëm i UÇK-së dhe kishte po ashtu vetëm dy-tre persona që punonin me të. Dhe ky mendimi juaj është? PË. Për z. Selimi unë thashë se e kam taku në zonën time. Dhe ka qenë me dy ushtarë. A kanë qenë staf apo vetëm ushtarë. Nuk e di. Nuk e di sa ka qenë përbërja e inspektorit a ka pasë staf ma të gjanë a nuk ka pasë. Ka qenë inspektor i përgjithshëm.

Sa për gjeneral, gradat mbas lufte janë dhënë apo janë marrë, nuk e di qysh ka shku situata. Gjatë lufte nuk kemi pasë grada Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Ky ishte opinioni i jem.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për procesverbal, unë u mbështeta në faqen 10302, rreshti 7 të transkriptit.

Pyetja ime është, ju nuk jeni takuar me z. Selimi në dhjetor të 1998, janar të 1999 kur keni qenë në Shtabin e Përgjithshëm në Kleçkë, pra, nuk jeni takuar me të, kështu? PË. Jo, atje nuk e kam pa Rexhep Selimin. E kisha njoftë me e pa në bazë të vëllait të tij, se Ramadan Selimin e kam pasë shok të organizatës ilegale, organizatës atdhetare. Rexhën e kam njoft në luftë kur ka ardhun në Nishor, në zonën operative të Pashtrikut. Vetëm e kam njoftë si Rexhep Selimi. As e kam ditë bile që është inspektor, pastaj e kam mësu, pastaj e kam mësu që është inspektor i përgjithshëm.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Gjatë kohës që keni qenë në selinë e Shtabit të Përgjithshëm, as folët, as nuk biseduat me ndonjë nga vartësit e z. Selimi? keni parë ndonjë zyrë atje, kështu?

PË. Jo, nuk ia kam njoftë vartësit. As sot nuk e di stafin e Rexhep Selimit kën e ka pasë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe ju thatë para disa minutash se e keni takuar dy herë, pra, z. Selimi, kështu, gjatë luftës?

PË. Mund. E mbaj mend mirë që e kam takuar një herë. Nuk e mbaj mend dy herë. Një herë dhe ka kalu nëpër zonë teme. Më ka ndodhur atje një betejë e rastit, siç e kam shpjegu, përndryshe nuk e mbaj mend dy herë që e kam taku. Nuk e mbaj mend.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po i referohesha asaj që thatë herën e fundit, para dy javësh keni thënë, na thatë se z. Selimi erdhi në zonën tuaj edhe ra në pritë, kështu e quajtët herën e fundit?

PË. Po, po. Kështu ishte situata.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni kur ka ndodhur kjo? Kur ka ardhur z. Selimi në zonën tuaj në prill të 1999 apo në një periudhë tjetër?

PË. Në prill të 1999. Datën s'e di saktësisht. Po ka qenë diku nga mesi i prillit apo fillimi i prillit, prill 1999.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe përveç kësaj vizite, z.

Selimi nuk ka ardhur më tek ju për të inspektuar trupat, as në 1998 kur ishit komandant i batalionit dhe as në 1999 kur u bëtë zëvendëskomandant zone?

PË. Në 1998 nuk ka ekzistu, s'besoj që ka ekzistue emërimi i tij, inspektor i përgjithshëm, në 1998. S'besoj që ka ekzistu. Ndërsa inspektim, nëse e quani inspektim të mirëfilltë profesional, nuk di që ka bë. E di që ka ardhë te unë për të kalue me një zonë tjetër. Po ndoshta dhe ka bë inspektime në nivel brigadash po nuk ka raportu. Unë nuk kam ndonjë raport të veçantë. Po jam ma shumë i bindun se ka bë vizita rutinore dhe kështu ka mujt me marrë informacion të saktë si është gjendja me një brigadë.

Dhe aty ku thoni se dy herë e keni taku, kam thënë dy brigada ka pasë mundësi me i taku, se ishte një brigadë shumë afër zonës ku isha unë zona operative e Pashtrikut dhe një brigadë ishte ma lart, brigada 121 ka ka shku ai. Në këtë kuptim e kam thënë që ka mund t'i vizitojë dy brigadat. Nuk e di a i ka bë vizitë a s'ju ka bë. Po mendimi im ishte ky.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sapo thatë se është bindja juaj se ka kryer vizita rutinë dhe ka mbledhur informata mbi situatën e përgjithshme. Pyetja ime është nga e dini ju këtë? Se jeni takuar veç një herë me të?

PË. Unë mendoj se nuk kam gjet dikund ndonjë raport konkret, ndonjë dokument, që ai ka inpsektue ose ka lënë gjurmë të inspektimit. Për këtë thashë në mënyrë rutinore kam mund me

qenë. Opinioni jem.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëj një pushim tani, z. Dëshmitar. Do të rikthehemi në orën 12.00.

Znj. Asistente e Sallës, mund të shoqëroni dëshmitarin.

Mos flisni me askënd për dëshminë tuaj, siç kemi porositur përpara.

DËSHMITARI: Okei. Okei.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

--- Pauza fillon në orën 11.32

--- Seanca rifillon në orën 12.01

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutemi shoqëroni dëshmitarin të hyjë në sallë.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më dëgjoni në rregull, dëshmitar?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë në rregull.

Gjykatësi Barthe ka edhe disa pyetje të tjera për ju.

Gjykatësi Barthe, vazhdoni.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi Smith.

Kam edhe disa pyetje përpara se ta marrë fjalën Gjykatësi Mettraux.

Gjatë kundërpyetjeve që jua bëri Avokati i Selimit, ju diskutuat më tepër ngritjen e të ashtuquajturës Qeverisë së Përkohshme të Kosovës në mars dhe prill të vitit 1999, dhe ju pyeti Avokati i z. Selimi se kush i zëvendësoi disa prej këtyre individëve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së të cilët u bënë anëtarë të QPK-së, pra të qeverisë së përkohshme të Kosovës.

Gjithashtu, ju këtë e diskutuat dhe me Mbrojtjen e Veselit në seancën e fundit, por fatkeqësisht nuk patëm kohë të mjaftueshme dhe sikur u ngatërruam disi. Për t'i sqaruar gjërat, atëherë dëshirojmë, dëshiroj t'ju bëj këtë pyetje. A mund të na tregoni diçka më shumë sa i takon marrëdhënies së Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe Qeverisë së Përkohshme të Kosovës asokohe? Nëse ju kujtova qartë ju thatë që asnjëri prej të katër të akuzuarve këtu nuk u hoq nga posti, apo nuk u zëvendësua në postin që kishin pasur dhe kishin ushtruar dhe i ushtronin. Kjo do thotë që mund t'i kenë ushtruar të dyja rolet njëkohësisht, kështu?

PË. Unë nuk jam në dijeni se ka pasë ndonjë vendim të caktuar për t'i lanë ato vende vakante ose për ta caktu dikënd tjetër. Ka mundësi që z. Çeku ka emëru dikënd tjetër, por derisa unë nuk e di kush kanë qenë të tjerët, unë i di këta që kanë qenë. Dhe kur është kriju Qeveria e Përkohshme, nuk kam qenë në

njohuri. Shumë, shumë pak kam ditë për Qeverinë e Përkohshme, e kam ditë që Azem Syla është ministër i mbrojtjes, e kam ditë që Hashim Thaçi është kryeministër i përkohshëm. E kam ditë që Fatmir Limaj, Fatmir Limaj është zëvendësministër i mbrojtjes. Për Rexhep Selimin e kam mësu më vonë që është si duket edhe është caktu ma vonë, ministër i rendit.

Përndryshe, nuk e di as kush i ka caktu, as si i kanë caktu, dhe si i kanë lanë vendet e tyne. A kanë mbetë vakante apo i ka zëvendësu dikush tjetër, që unë nuk e di. Kjo është shumë reale. Ka mundësi z. Çeku me ditë për shkak se ai është emëru shef i shtabit më 17 prill 1999. Nuk ka qenë shefi i mahershëm Bislim Zyrapi, ka qenë në operacionin Shigjeta. E vetmja kjo është që mund të dihet saktë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, për t'ju pyetur veçmas. Keni apo nuk keni dijeni që z. Thaçi të jetë larguar nga Shtabi i Përgjithshëm apo të jetë zëvendësuar nga Shtabi i Përgjithshëm pasi u bë kryeministër i qeverisë së përkohshme të Kosovës?

PË. Opsioni jem është që ata asnjeni s'janë kthy në Shtabin e Përgjithshëm dhe asnjëri s'kanë takuar komandantë të zonave mbas Rambujesë. Dhe kjo është nji indinjatë e imja, pse është lanë ashtu pezull i gjithë funksioni i Shtabit të Përgjithshëm që s'ka ekzistu. Vetë Agim Çeku ka qenë shef i shtabit në këtë kohë dhe unë s'kam njoftë tjetërkënd që ka ekzistu ma në shtab. Na kanë lanë kështu vetëm neve, nivelin e zonave dhe

brigadave.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] T'ju pyes tani në lidhje me z. Selimi, jeni apo nuk jeni në dijeni që është, të jetë larguar apo zëvendësuar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së pasi u bë ministër i rendit publik në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës?

PË. Unë jam i bindun që aty dikush është dashtë ta zëvendësojë. E kush e ka zëvendësu, nuk di. Nuk jam në dijeni. S'e di për cilin Selimi e keni fjalën, ju lutem dhe nji herë z. Gjykatës. Është Sylejman Selimi dhe Rexhep Selimi, të lutem.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po, sigurisht. E kam fjalën për z. Rexhep Selimi.

PË. Rexhep Selimi në Qeverinë e Përkohshme sa di unë ka qenë ministër i rendit. Dhe nuk di kur ka dalë prej Shtabit të Përgjithshëm, a është lanë, a u caktu dikush që ta zëvendësojë, apo ka mbetë vakant ai vend, nuk di.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Po për z. Veseli i cili sipas Prokurorisë u bë shef i Shërbimit Informativ të Kosovës, apo ministër i shërbimit informativ në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës? Ky u largua apo u zëvendësua nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së? Nëse keni dijeni?

PË. Nuk e di datën e caktume kur është formuar shërbimi informativ i Kosovës, nuk e kam datën e caktume, nuk di. Deri më 12 qershor unë e kam llogaritë zbulim-kundërzbulimin,

strukturë për këtë çështje. Kur është themelu shërbimi informativ, unë nuk di.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, nuk mund të thoni nëse z. Veseli u zëvendësua apo nëse u largu nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, kjo është dëshmia juaj këtu?

PË. Ashtu është, saktësisht tamam ta thotë z. Veseli edhe shefi i shtabit, Agim Çeku. Ata mund ta dinë a ka pasë dikënd Agimi, a ka caktu dikë ndonji njeri? Thonë se dikush ka qenë aty, por kush unë nuk di. Nuk di.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dëshmitar, në fund. Po z. Krasniqi, Jakup Krasniqi, a u largua apo u zëvendësua nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, me sa keni ju dijeni?

PË. T'ju them të vërtetën unë këtu e mësova çfarë roli ka pasë në Qeverinë e Përkohshme, si zëdhënës paska qenë edhe atje, edhe derisa ka qenë në UÇK-së ka qenë zëdhënës. Edhe atje paska qenë zëdhënës. Nuk e di kur e ka marrë atë detyrë, as kur është largu. Unë e kam taku, datën e fundit që e kam pa z. Krasniqi është dikund 20 apo 22 janar 1999. E kam pa te Shtabi i Përgjithshëm, në oborr të Shtabit.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, me fjalë të tjera, nuk keni dijeni nëse është larguar apo zëvendësuar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së?

PË. Në këto dy pika që ju pyesni se kush i ka zëvendësu vendet e tyre, a kanë mbetë vakante a janë zëvendësu me dikënd, kur kanë kalu këta në Qeverinë e Përkohshme nuk kemi

dijeni fare, s'është bisedu fare, s'është diskutu me neve të zonave. I kanë bo kështu vetë ata qysh kanë ditë vetë, edhe ne s'kemi pasë njohuri.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, për procesverbal e kisha fjalën për faqen 10325 dhe në vijim të transkript dhe këtu mbyllen dhe pyetjet e mia. Faleminderit shumë, z. Dëshmitar.

PË. Faleminderit z. Gjykatës.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi Smith.

Mirëdita, z. Dëshmitar. Dëshiroj që ta filloj me diçka për të cilën ju pyeti z. Barthe. Nja dy herë ai ju pyeti nëse në dijeninë tuaj a u bë apo jo ndonjëherë Adem Demaçi anëtar i Shtabit të Përgjithshëm? Nuk jam i sigurt nëse kemi marrë një përgjigje për këtë pyetje.

Ju lutem, na thoni, me aq sa keni ju dijeni, Adem Demaçi u bë ndonjëherë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm apo jo?

PË. Me sa unë e kam dijeni edhe opinioni jem është që ai duhet të ishte udhëheqësi i Shtabit të Përgjithshëm, sepse nëse përkthejmë luftën ose ushtrinë në gjendje civile më i madh është presidenti, ose ma i madh është kryeministri, se sa komandanti i ushtrisë. Në këtë rast ai ka qenë përfaqësues politik, njeri numër nji. Unë kështu e perceptoj edhe mendoj që kështu duhet të jetë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ta bëj për një herë të

katërt pyetjen. Me sa keni ju dijeni, a u bë ai ndonjëherë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm apo jo?

PË. Unë jam i bindun që po, edhe ai ka udhëheqë politikat e luftës.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Do t'ju pyes për diçka për të cilën ju pyeti edhe Avokati i Thaçit dhe Prokuroria, për listën e bashkëpunëtorëve, kolaboracionistëve. Pra, ju kujtohet ta keni diskutuar, që folët më saktë për këtë temë?

PË. Ma konkret, ju lutem, z. Gjykatës?

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet që i keni thënë Prokurorit se gjatë luftës, po përdor shprehjen tuaj, keni parë shumë lista bashkëpunëtorësh. Ju kujtohet që keni thënë këtë?

PË. Jo, shumë lista nuk kam thanë. Nuk kam thanë shumë lista, por nji listë më ka ardhë në batalionin e Budakovës, e kam pasë grisur, dhe nji listë e kam pa këtu nga Prokurori të prezantuar që nuk munda me ditë se kush e ka nënshkru, s'e njoha nëshkrimn, me goxha shumë emra të tillë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'i kthehem kësaj liste pas pak, por prova P707, Pjesa 5, faqja 7, këtu jeni regjistruar që keni thënë që:

"Shumë herë më kanë dhënë lista njerëzish të konsideruar si bashkëpunëtorë."

A është e pasaktë kjo?

PË. Nuk ka mundësi shumë herë, ka mundësi ndoshta dikush ka pru nji cedulë të vogël, nji listë me dy-tre emna, e ka taku nji ushtar në rrugë, ka thanë, çoji qeta tre emra se këta muj me kanë kështu-kështu. Por realiteti është për ato dy lista që folëm.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, sot nuk ju kujtohen më shumë se dy raste kur keni parë lista të tilla, kështu?

PË. Po.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Na thatë se ju kujtohet një rast kur ju dha një listë këshilli i fshatit, kështu?

PË. Po.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Çfarë pamje, si ishte kjo lista? Domethënë e shkruar me dorë, e shtypur në makinë të shkrimit, ça forme kishte ky dokument pikësëpari?

PË. Ishte shkruar me nji fletore me stilolaps, me dorë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më duket se thatë që i njihnit disa prej emrave në atë listë, kështu?

PË. Po, kam njohur. Kam njohur emra. Sepse kanë qenë bashkëfshatarë të mi.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sa emra ju kujtohet, afërsisht, afërisht, sa emra kishte ai dokument?

PË. Dikund 16 apo 18 emra.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kemi kuptuar qartë që ju e kuptuat që këta persona dyshoheshin si bashkëpunëtorë të autoriteteve serbe?

PË. Duke i njohu personat, unë e dija që nuk kanë mundë të jenë bashkëpunëtorë dhe dija që nuk kanë bo ndonji dam të caktuar në mesin e komunitetit tonë aty në fshat dhe në rrethinë, dhe si të tillë nuk i akseptova as listën, nuk pranova edhe t'i quaja si kolaboracionistë apo bashkëpunëtorë, e shkeva listën e sjellur.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'i kthehem asaj që bëtë ju. Pyetja ime ishte e qartë, duket, po ata që jua dhanë këtë listë, ata dyshonin që këta individë mund të ishin kolaboracionistë të serbëve, mirë?

PË. Po, ishte ashtu. Ata dyshonin për shkak se këta, ndër këta njerzit, kishte që kishin shitore të vetën, taksi të vetin, makina qarkulluese, kishin qasje me palën serbe, dhe kishin kontakte, simbas tyne, këta pinin, hanin bashkë, kështu diçka. Në bazë të kësaj ata kanë konstatu që janë të atyre, janë bashkëpunëtorë të tyre. Por nuk ishte kjo e vërtetë për mu, nuk u pranu si e vërtetë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju thatë që e shkatërrutë atë listë, e asgjësutë?

PË. Po, po.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E asgjësuat sepse, siç e kuptova unë, është që mund të kishit shqetësim se mos lëndoheshin këta persona, kështu?

PË. Ishte shqetësimi i jem që ata moralisht mund të lëndoheshin shumë, dhe shqetësimi jem që ato lista mos të

binin nëpër durë të të tjerëve që dikush për interesa hakmarrje apo qëllime të veta të bante ndonjë skandal me njerëzit e pafajshëm. Sepse ta fajësosh dikën për nji gjë të tillë, nuk do të thotë se e fajëson vetëm individin por fajëson edhe të ardhmen e tij, edhe nipat e tij, edhe stërnipat e tij, kështu që ishte një dam i madh. Pastaj, për atë edhe asgjësova letrën.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ishit, ma merr mendja, i shqetësuar se mund t'u bëhej edhe dëm fizik këtyre bashkëfshatarëve, ata që ishin në listë?

PË. Po, normal që jam frigu në atë drejtim se dikush për hakmarrje do të bënte nji veprim të tillë, edhe nuk doja që të ndodhshin gjana të tilla. Qoftë mbrenda UÇK-së, qoftë edhe mes civilëve.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Besoj se e pranoni që krahas fshatit pra, këshillit të fshatit, për të cilin na keni thënë, edhe shërbimi i zbulim-kundërzbulimit ishte i përfshirë, le të themi, në mbledhjen e informatave për kolaboracionistët, kështu?

PË. Në këtë kohë nuk ka pasë strukturë të ZKZ-së, shërbimit të zbulim-kundërzbulim. S'ka pasë, ka qenë shumë herët, në fillim të luftës.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'i kthehem çështjes së strukturës pas pak, por do t'ju lexoj atë që keni lexuar dhe është, është prova P707.7, keni thënë që:

"Nëse keni dijeni, personat, zyrtarët e ZKZ-së a kanë qenë të përshirë apo jo në mbledhjen e informatave sa i takon listës së kolaboracionistëve?

"PË. Besoj se kishin prova, por po flas për vete dhe unë po flas për pjesën e parë të luftës kur flas për vete, kur isha komandant batalioni. Përndryshe, më mbrapa nuk ishte përgjegjësia ime, por besoj se mbanin shënime."

Doni që ta ndryshoni këtë dëshmi që keni dhënë, apo, ose dëshironi që ta mbani këtë që i keni thënë lidhur me mbajtjen e shënimeve për kolaboracionistët e dyshuar asokohe?

PË. Jo, nuk dua ta ndryshoj fare, z. Gjykatës. Vetëm dua t'i ndaj etapat, ju lutem. Të kuptohemi se po përzihen etapat. Nëse flasim për fillimin e luftës, s'ka pasë strukturë të zbulim-kundërzbulimit. Nëse flasim për 1999, pas 1 prillit, mund të them që ka pasë strukturë të zbulimit dhe të kundërzbulimit. Nuk e ndërroj asnjë presje, asnjë pikë. Vetëm ndajeni në etapa, ju lutem, më kuptoni.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, po tregojmë kujdes. Ju garantoj. Por ajo që ju pyes është kjo: Me sa keni ju dijeni, shërbimi informativ, apo ZKZ-ja -- do ta ndaj në dy pjesë, nëse mbanin shënime për kolaboracionistët? Nuk ka rëndësi data, pas pak do t'ju pyes për datën. Pra, a mbanin apo jo shënime për kolaboracionistët, me aq sa keni ju dijeni?

PË. Unë nuk e di a i kanë rujtë ato shënime a i kanë mbajtë, por e di që nëpër shumë komanda janë sjellë nga civilë lista

të tilla. Tash nuk e di, nuk jam i sigurt, se a i kanë mbajtë ato, a i kanë rujtë ato shënime, ku i kanë pasë. Nuk kanë qenë të detyruar të mbledhin shënime të tillë. Kanë qenë të detyruar të zbulojnë armikun, armët e armikut, qëllimet e armikut, sulmet e tyre, vendqëndrimin e tyre. Për këtë kanë qenë dhe si strukturë të caktuar.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të qëndrojmë tek shënimet për kolaboracionistët.

Me aq sa keni dijeni, këto shënime që i keni përdorë në intervistën tuaj me ZPS-së, pra me aq sa ju keni dijeni, ky shërbimi informativ, apo ZKZ-ja, kur filloi që të mbante shënime për kolaboracionistët? Dhe e kam fjalën për zonën tuaj sigurisht.

PË. Por nuk ka pasë ndonjë datë të prerë kur duhet të fillojë, kur duhet të mbarojë. Ose duhet të marrë, ose të mos marrë shënime. Ka, mund të ketë shënime thashë, dhe nuk e di.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të përpiqemi të shohim tani një dokument që të na ndihmojë që t'i përgjigjemi kësaj.

Zyra Administrative, ju lutem na nxirrni provën me numër P711, të modifikuar.

Ju kujtohet që jua kanë treguar ZPS-ja këtë listë në dëshminë tuaj para dy javësh që dhatë këtu?

PË. Nuk po e shoh të plotë, por më duket që kjo listë ka qenë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, dhe më duket se

identifikuat, do t'i marrim faqet me radhë. Mos u shqetësoni për faqet e tjera. Por më duket se keni identifikuar pesë individë në këtë listë. Në numrin 24, 25, 53 dhe 54, dhe 58.

PË. Këtu mungon numri 24, 25. Mungojnë ato numra këtu në faqe.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju lutem, Sekretarisë, që të kalojë në faqen tjetër.

Në fillim numri 24 dhe 25, Ymer Bytyqi, Jakup Bytyqi, ju kujtohet që i identifikuat këta?

PË. Po, po, po.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kaloj tani në faqen tjetër, ju lutem. Tani numri 53 dhe 54, Latif Dulla?

PË. Po.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Glauk Dulla, Vesel Krasniqi --

PË. Po.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] -- dhe 58, Qerim Buzhala.

PË. Po.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe këta janë ata të cilët, me sa kuptoj unë, i keni identifikuar si persona të cilët kishin bashkëpunuar me Serbinë, kështu?

PË. Po, kështu është. Qerim Buzhala ka qenë polic, milic, atëherë janë quajt "milicia". Ka qenë milic i shërbimit jugosllav, ndërsa Latif Dulla ka qenë inspektor i lartë i shërbimit sekret jugosllav në Prizren, i cili më ka torturu

mua në tortura kur jam burgosë.

Njëkohësisht, ka qenë edhe Vesel Latifi, torturues, dhe ka qenë shef i shërbimit sekret për Prizrenin, dhe rrethinën e Prizrenit. Dhjetë vite, njimbëdhjetë vite, ka qenë shef i shërbimit sekret.

Atëherë më thatë mos me i përmendë emrat, por mirë bënët që i përmenda.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jo, jo. Lirisht mund t'i përmendni. A e dini se çfarë u ka ndodhur këtyre pesë njerëzve gjatë konfliktit?

PË. E di që Vesel Krasniqi ka vdekë pas luftës. E kam taku pas luftës në rrugë e kam taku. Nuk kam dashtë as të hakmerrem kur mund të hakmerrem. Hala kam qenë i armatosun, por s'kam dashë të hakmerrem se qëllimi jonë ka qenë mos me u bo vllavrasje se i kemi pa se çka ka ndodhë në Bosnje me vllavrasjen e tyne, u bënën dy ushtri të Bosnjës myslimanë u vranë me veti, kemi pa çka ka ndodhë në Palestinë, te kurdët, te shumë vende kështu. Nuk kemi dashtë të kemi vllavrasje mes veti, kemi duru dhunuesit edhe pse kena mundë t'i hakmerremi.

Nuk e kemi ba as para lufte, as gjatë lufte, as mbas lufte.

Përndryshe, ky Latif Dulla është gjallë akoma. Jeton në shtëpinë e vet. Nuk kam dashtë të hakmerrem konkretisht me të. edhe pse më ka torturu direkt vetë. Qerimin e kam taku para dhjetë vite, Qerim Buzhalën. Qerim Buzhala më ka shpjegu që ka

qenë i rrahur, po më ka thanë që në Shkodër e ka rrahë dikush. Ka qenë me nji darsëm atje në Shkodër, në Shqipëri. Dhe është rrahë nga dikush. Ka qenë në spital.

Ai ka kërku të takohet me mu, kemi pi kafe në fshatin tem, dhe me shumë respekt më ka taku. Po dhe unë s'kisha ndonjë vërejtje. S'kam pasë ndonjë gjë personale me të kurrë. E shprehu respektin edhe haptas kështu, tha "Me pasë ditë shumë herët kisha ardhë në luftë te ti, që më respekton kaq shumë, kisha ardhë me luftu bashkë.", thashë "Pse s'ke ardhun, mirë kishe bo të kishe ardhë". Kaq di për të.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kalojmë tani në faqen tjetër, në të dyja gjuhët ju lutem. Këtu sugjerohet se është një listë e personave të dyshimtë. Ju, edhe ju kështu e kuptoni këtë që këta persona ishin renditë në këtë listë sepse dyshoheshin se kishin bo diçka?

PË. Dikush e paska bo këtë listë. Unë si emën po e njof edhe si njeri këtë Ulusi Badallaj, i cili ma ka dhuruar nji xhip gjatë luftës. Xhipin e tij e kam mbajtë deri në fund të luftës, derisa u shkatërru nga forcat serbe.

Xhemajli Shasivarin vetëm si emën kam dëgju, nuk e di kush është.

Gynerin ashtu kam dëgju si emën, nuk e di kush është.

Isuf Halimi, prej Opoje, as këtë nuk po e njoh.

Nuk e di kjo listë ku është gjetë. Ky shumë i mirë është me numrin 61, është për mu njeri ma i miri. Akoma kemi raporte

shumë të mira. Gjallë është ky. Nga ana e Zhurit, nga fshati i Zhurit.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju pyes edhe për disa, për persona të tjerë që janë në këtë listë, por hë për hë, na thoni ku qëndron kjo lista me listën që keni marrë nga këshilli i fshatit?

PË. Jo, jo. Këta nuk janë nga ana e fshatit tim ,as të fshatrave përreth. Janë ma larg, njani është i Opojës, këtu po shkrun, tjetri është i Zhurit. Këta të tjerët nuk e di të cilit vend janë, jo nuk janë --

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më falni, jo. Nuk është kjo pyetja, nuk ishte e qartë pyetja. Lista që keni përpara, si, domethënë, si mund ta krahasojmë, le të themi, a ngjan apo nuk ngjan në formë, në stil me listën që keni marrë nga këshilli i fshatit? A është e ndryshme, a është e njëjtë? Le të themi, në formë flasim gjithmonë, jo në përmbajtje, diçka që vini re?

PË. Këtu vë re se konkan me të shtypit të gjitha shkronjat, edhe me numra. Atje për shembull lista që ka ardhë, ka ardhë pa numra, pa shkronja të shtypit. Shkruar kështu me dorë. Nji dallim i vogël.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A do të ishte e drejtë nëse do të thoshim që kur folët me Prokurorin, nxorët konkluzionin apo krijuat mendimin se kjo listë duhet të jetë bërë nga shërbimi informativ apo ZKZ-ja, ju kujtohet që e

thatë kështu?

PË. Jo, kjo listë si e pashë më përpara dhe tani që i shoh këto emna, sigurisht ka ardhë dikund nga dikush që ka qenë në shërbim sekret të ish-Jugosllavisë apo polic dhe kështu hamendësova, ndoshta mendova gabim, ndoshta drejt, që thashë Nasemi Mullabazi ka mujtë me bo, për shkak se ka qenë polic i Jugosllavisë, në Brigadën 124 ka qenë i kyçur ushtar. Kështu e kam thanë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju lexoj se çfarë thatë. Është prova me numër P707. Ju është bërë pyetja:

"A është kjo, a ka pasë këtë pamje lista që keni marrë ju?

Ju thatë:

"Jo, kjo e ka një rend. Këtë duhet ta ketë shkruar ndonjë nga sektori i kundërzbulimit apo dikush që ka mbajtë shënime zyrtare. Shënimet që unë kam parë kanë kështu copa letre.

"PY. Çfarë ju shtyn të mendoni se kjo ka ardhur nga një person nga kundërzbulimi apo dikush që e ka mbajtur një, që ka mbajtur shënime zyrtare?

"PË. Sepse," keni thënë ju, "është me një rend, ka një renditje, është me shkrim dore të mirë. Diçka që duket shumë në rregull, ka një renditje."

Pra, po e ndryshoni sugjerimin që i keni bërë ju Zyrës së Prokurorit të Specializuar që është si diçka që ka punuar, pra që vjen nga sektori i kundërzbulimit apo dikush i cili e ka

bërë një shënim zyrtar?
PË. Nuk kisha dashtë ta ndryshoja asnjë presje dhe nëse është ashtu, edhe gabimisht nëse është, le të mbetet ashtu. Por unë mendoj se kam thanë dikush nga shërbimi sekret jugosllav e ka bë këtë, jo nga shërbimi i zbulim-kundërzbulimit. Mendoj kështu, ndoshta mund -- po tha Prokurori kështu, është kështu, le të rrinë. Unë mendoj kështu siç po them.
GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po, mbi ç'baza e keni ju këtë sugjerim, që ju thatë shërbimi sekret serb apo jugosllav është përgjegjës për këtë listë? Ku e bazoni ju këtë, si e bëni këtë sugjerim?
PË. Në bazë të njohjeve të emrave, dhe në bazë të punës të bërë, principit të punës, mënyrës të renditjes. Në bazë të kësaj kam konstatuar që dikush mbrenda këtij shërbimi ka qenë që i ka njoftë kaq mirë. Që zbulim-kundërzbulimi kish mundë me nxjerrë nji emën, dy emna, tre emra, jo kështu nji listë të mirëfilltë, domethënë, me shumë emra, 63 numri këtu ekziston.
GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kuptoj. A ju kujtohet kush i kryente funksionet e zbulimit dhe kundërzbulimit në zonat tuaja në zonën tuaj në fillimet e luftës? Qershor, korrik, gusht. Kush person ka qenë përgjegjës për këto detyra?
PË. Kemi thanë me dhjetëra herë që s'ka pasë zbulim-kundërzbulim, s'ka pasë strukturë atëherë të zbulim-kundërzbulimit deri në vitin 1999. Domethënë, nëse diçka të tillë kanë pru, kanë pru nëpër komanda civilët, fshatrat. Të

tillë diçka si kjo nuk kam pa. Kjo konka me renditje të duhur dhe është me numër shumë të madh dhe shumë me saktësi, kush ka qenë dhe ku ka qenë, nga kush ka ardhë. Domethënë këtu shifet që është nga Zhuri, është nga Opoja, është nga Dragashi. Kështu me radhë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ju ndaloj. Nuk e kam hallin te struktura, nuk po ju pyes për strukturën. Po ju pyes cilët persona, na jepni emrat që ju kujtohen. Personat që kanë kryer punën e zbulimit, përfshirë edhe marrjen e informacionit, mbledhjen e informacionit për kolaboracionistët në zonën tuaj, për periudhën qershor, korrik dhe gusht. Ju kujtohen emrat?

PË. Ju kam thanë, z. Gjykatës, që nuk kemi pasë atëherë struktura të zbulim-kundërzbulimit. Nuk kanë pasë persona të caktumë, të emërtumë, për t'i grumbullu këto. Më duket e kemi të qartë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ju pyes kështu, a e njihni një person me emrin Safet Krasniqi?

PË. Si emën, po.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na thoni çfarë funksioni kishte ky person?

PË. Vetëm e di që ka qenë në Brigadën 125. Komandant e ka pasë Nehat Bashën. Çfarë funksioni ka pasë, nuk di, nuk di. E di që ka qenë ushtar i UÇK-së, Brigada 125, te komandant Basha.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Çfarë keni dashtë të thoni kur i keni thënë Prokurorisë se bashkëpunonte me ZKZ-në ai, çfarë keni dashtë të thoni atëherë me këto fjalë?

PË. Nuk e di se ka qenë e organizume në Brigadën 125, zbulim-kundërzbulim dhe nuk e di cili ka qenë S1, S2, në Brigadën 125. Nuk e di. E di që është folë edhe emri i tij, edhe dy tre emra të tjerë, por nuk e di çfarë roli ka lujtë, sinqerisht nuk e di.

Se jemi kanë nëpër nivel brigade siç e kanë qenë në nivel të zonës G2, nivel Shtabi i Përgjithshëm J2, nivel brigade ka qenë S2. S2. S2 i Brigadës 125 nuk e di kënd e ka pasë shef.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim çfarë keni thënë. Ju keni thënë që e keni dëgjuar emrin të përmendej, të përmendej lidhur me aktivitetet e zbulimit dhe kundërzbulimit, korrekt?

PË. Si emër e kam dëgju. Si emër po, por nuk di çfarë roli ka pasë, sinqerisht.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po çfarë keni dashë të thoni, po ju pyes sërish. Në pjesën 4 të intervistës së ZPS--së që është prova materiale P707, ju keni thënë që Safet Krasniqi bashkëpunonte me ZKZ-në. Çfarë keni dashë të thoni me këtë?

PË. Si emër i njohur për mu. Mendimi im ka qenë se ai është në bashkëpunim me ZKZ-në, po a ka qenë strukturë a ka qenë shefi i zbulim-kundërzbulim, a zëvendës a çfarë ka qenë, rolin

nuk ia di. Sinqerisht nuk ia di. Veç e di që ka qenë në Brigadën 125 të komandant Basha.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe pseudonimin e kishte Arditi?

PË. S'po më kujtohet pseudonimi. Ndoshta.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përmendët dhe dy persona të tjerë për ZPS-në, siç ju kujtoheshin asokohe, ishin anëtarë apo bashkëpunonin me ZKZ-në, Elbasan Shoshaj dhe Skënder Berisha, saktë?

PË. Po. Këta emna i njoh. Këta emna i njoh, edhe jam i bindun që kanë qenë bashkëpunëtorë me ZKZ-në.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po në nivel brigade, në atë periudhë, qershor-korrik të 1998, kush ka qenë përgjegjës për zbulimin dhe kundërzbulimin?

PË. Unë po them që s'kemi pasë strukturë për zbulim dhe kundërzbulim në 1998. Z. Gjykatës, s'e di sa po më kuptoni. Ndoshta dikush ka dhanë të dhana të tilla, ju keni të drejtë, por unë sa jam në njohuri dhe sa di unë, nuk ka ekzistu strukturë zbulim-kundërzbulimi në 1998. Ndoshta këta i kanë shërby komandantit të vet, apo njësisë së vet, apo nuk di si mund t'i qujmë, por struktura e ZKZ-së nuk ka qenë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për shembull, ju s'keni dijeni për Iliaz Kadollin, nuk e dini që Iliaz Kadolli kryente funksionin e zbulimit dhe kundërzbulimit në 1998 në brigadën tuaj?

PË. Jo, s'ka qenë kurrë. Në zbulim-kundërzbulim, jo. Ka qenë nji lloj këshilltari juridik se ka pasë fakultetin juridik, fakultetin juridik, nuk ka qenë zbulim-kundërzbulim Ilaz Kadolli. E njoh Ilaz Kadollin, e kam njoftë edhe para lufte, edhe pas lufte. Tash nuk e di ku është.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po keni ndonjë dijeni që edhe Isa Morina të kryente funksionin e zbulimit apo kundërzbulimit në vitin 1998?

PË. Jo, në 1998, z. Gjykatës, të lutem. Të mos i ngatërrojmë etapat, 1999 ka qenë S2, po. Ashtu është, si po thoni ju. Por jo 1998. Veç për pak e ngatërroj me të, por.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk po përpiqem që t'ju ngatërroj. Kur them kundërzbulim a zbulim, unë e përfshij edhe S2, nëse preferoni të them S2. Unë e kam fjalën për personat që mblidhnin informata për kolaboracionistët. Nuk po flas për civilë këtu, po flas për anëtarë të UÇK-së, a po kuptohena?

PË. Shumë mirë po kuptoj, por unë nuk e kam pasë atë detyrë të punoj me G2, as me S2, as me mbledhjet e informacioneve. S'muj me i ditë të gjitha. Mos kërkoni nga unë, kërkoni nga ata që po i përmendni këtu. Isa ka qenun, Isë Morina, S2, ai tjetri ka qenë bashkëpunëtor, Ilazi ka qenë këshilltari juridik. Lypni përmes atyne që i dinë këto, jo përmes meje se s'kam qenë unë i detyrumë me i mbledhë këto gjana. As nuk më kanë vyjtë asnji send.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull. I lutem Zyrës

Administrative të vendosë në ekran provën materiale P651 MFI. Për procesverbal, mban numrin ERN U000-6550-U000-6598.

Do t'ju kërkoj të shihni dy dokumente, që do të dalin në ekran për pak. Fillojmë me këtë që ta kuptoni kontekstin. Duket se është një fletë blloku, nga përmbajtja siç do ta lexoni, thuhet se është përgatitur nga një person nga shërbimi i zbulimit.

Unë, besoj se e di përgjigjen, por fillimisht po ju pyes, e keni parë më përpara këtë dokument?

PË. Jo, kurrë. Edhe kjo Impex? Po më jep përshtypjen që ky dokument mund të jetë i pasluftës, nuk e di që ka ekzistu kjo Grafik Impex para lufte apo gjatë lufte.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Data në dokument është 19 korrik 1998. E shihni?

PË. Po datën e shoh, dhe më habit kjo.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim faqen U000-6553, ju lutem, fillimisht.

Edhe e njëjta faqe i përkon edhe shqipes.

Këtu, ju jap -- lexojeni këtë faqe, ju lutem. Dhe më thoni kur të keni përfunduar.

Për procesverbal, anglishtja është gabim. Thotë 19 korrik 1999. Duhet të kishte qenë 1998 tek anglishtja data.

Pyetja ime e parë është kjo. A keni dijeni për këtë incidentin që përmendet këtu?

PË. Jo, fare. Jo, për besë, edhe kjo paska qenë e disa

fshatrave rreth kufinit me Shqipërinë, Vërmicë, shkruan disa persona që në cilën brigadë është fjala, nuk e di. Dikund duhet me qenë, duhet me qenë në afërsi të kufinit nëse ka të bëjë me Brigadën 128, por kjo datë 1998 s'ka qenë as brigada atëherë. Nuk di, nuk jam në dijeni për këtë dokument.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Brigadë 125, apo jo? Afër.

PË. Po. Brigada 125, ka qenë. Por jo brigadë, ka qenë në niveli batalioni në këtë kohë. Batalioni i Vrrinit ka qenë, ka qenë Batalioni 2 në Vrrin. I Brigadës 125. Ka mundësi njerëz të asaj ane mund me u kanë afër kufinit.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jeni në dijeni për incidente të këtilla kur anëtarë të UÇK-së shkonin në Shqipëri për të marrë armë dhe sulmoheshin gjatë kthimit?

PË. Zakonisht në Shqipëri kemi shku kemi marrë armë ose kemi ble nga ata që na i kanë sjellë, kontrabandues. Por kemi pasë raste edhe kur kemi ra në prita, kam ra edhe unë në pritë kur kam hi nga Shqipëria, më 7 qershor 1998, kam hy në luftë dhe na u ka vra rrugërrëfyesi, komandant Haxhi Hoti, komandant Lleshi, nofkën Lleshi, dhe na u ka vra nji kalë i bardhë i ngarkumë me armë. Zakonisht kanë ndodhë këto prita gjatë hyrjes prej Shqipërisë të armatosur, kanë ndodhë pritat prej forcave serbo-sllave. Dhe incidente të tilla ka pasë të shumta.

283 luftëtarë apo ushtarë, si t'i qujmë, kanë ra në kufirin shqiptaro-shqiptar, mes Shqipërisë dhe Kosovës duke

kalu kufinin me armatim drejt Kosovës.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Shohim, ju lutem, faqen 6567 në anglisht, më duket se shqipja është 6568.

Këtu do të shihni një shënim, nga 22 korriku i 1998. Më thoni kur t'ju dalë në ekran. Aty ku është 22 korriku i 1998.

PË. 20 mars, shkrun. S'ka korrik, ju lutem, në shqip s'ka dalë akoma.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] S'është faqja e duhur. Ju kërkoj ndjesë, duhet t'u kisha thënë që faqja në gjuhën shqipe është 6568. E shihni paragrafin pas datës 22 korrik 1998?

PË. Shifet, ama 23, a 22 nuk e di. Se shumë është, shumë i përshkëllimë. Shumë e zorshme për t'u lexu kjo. Por shifet ky paragraf, po.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Thotë:

"Idajeti u mor për pyetje sot.

"Nga Sami Sulaj, Xhevat Berisha, Selman Berisha, Elbasan Shoshaj dhe të tjerë."

Së pari, e njihni kush është Idajet Ciga?

PË. Jo, jo. për herë të parë e ndëgjoj. E kam nji shok me emrin Idajet, por ai s'është në këtë. Idajet Hoti thirret. Ky Idajati kush është nuk e di, nuk kam njohuri për këtë emër.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por, Xhevat Berishën, dhe Elbasan Shoshajn e njihni, e dini kush janë?

PË. Po, Xhevati është tani hero. Elbasani është dikund në Prizren, por nuk di me çka merret a ku jeton. Veç e kam njoftë

si emër dhe si njeri.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Meqë po flasim për këtë, Xhevat Berisha ka vdekur më 1 shtator 1998, ose rreth kësaj date?

PË. Ofensiva e madhe e serbëve ka qenë në rrethinat e Vrrinit më 1 shtator, 2 shtator, 3, 4, dhe 5 shtator. Në këtë kohë kanë ra 19 dëshmorë, ka ra edhe Xhevat Berisha. Kështu është.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e njihni personin që është tek shënimi më poshtë, me emrin Zlatko Roksanovic? A e njihni këtë person?

PË. Jo, s'kam lidhje, sinqerisht ta them. Edhe duhet t'ju shpjegoj nji, ndoshta është shumë imtësi e vogël, por territorialisht Vrrini edhe pozita e shtabit tem në këtë kohë në Budakovë janë minimumi 50 deri 60 kilometra larg, dhe shumë të shkëputura. S'kam pasë mundësi me ditë në atë kohë kurrgjë. Dhe ky raport s'ka ardhë kurrë tek unë, as më vonë as në nivel të zonës. Kështu është.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ju nuk jeni dijeni që të ketë qenë oficer policie serbe ky Zlatko Roksanovic?

PË. Jo, nuk ka mundësi ta njoh se unë dhjetë vitet e fundit kam qenë Zvicër. Nuk kam qenë në Kosovë fare. Dhjetë vitet e fundit, domethënë, dhjetë vitet para luftës kam qenë në Kosovë. Nuk e njoh. Ndoshta ka qenë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim faqen 6557. E njëjta faqe duhet të jetë edhe në shqip. E shihni pjesën aty

ku fillon "Dosja: Fetah Fetahu - 21 korrik 1998"

PË. Po, e shof.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E dini kush është Fetah Fetahu?

PË. Jo, me mbiemrin dy Fetah. Fetah njoh, por Fetah Fetahu nuk njoh. Fetah njoh, Fetah Fetahu nuk njoh.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E shihni rreshtin tjetër ku thuhet se është kushëriri i Osman Fetahut --

PË. Po, e shof, e shof.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe kryetari i LDK-së për Kukën, është Kapllan Fetahu. E shihni këtë?

PË. E shoh, edhe nji e kalutë, djali i axhës të kryetarit të LDK-së për Kukë është Kapllan Fetahu. Nuk e njoh, janë distancë shumë e madhe. Kukë është në pjesën e Malësisë së Sharrit, është shumë lart, shumë thellë. Afër Shqipërisë atje. S'kam të bëj me këtë lidhje me këto data kur ka ekzistu Batalioni i Budakovës në Budakovë, këta janë kanë krejtësisht të panjohur për mu. Veç e kam ditë që ekziston nji njësi atje. Absolut asnji lidhje, as radiolidhje s'kemi pasë, as kurrfarë lidhje fizike. Edhe pas andej, edhe gjatë luftës edhe, kur kam qenë zëvendëskomandant i zonës, kurrë në atë pjesë nuk kam qenë se është shumë thellë. Shumë larg është, duhet kaluar Prizreni, nuk ka pasë qasje.

Bile edhe komandanti i brigadës së tyne, që ka qenë Nehat Basha, nuk ka pasë me atë batalion asnjiherë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Vetëm na thoni ato që dini. Kur s'e di, s'e di.

Shihni pak më poshtë në të njëjtën faqe. Përmendet një person me emrin Naser Arifi, drejtori i Komercës së Kukës, Komercit të Kukës.

PË. Po, e shof, e shof. Por nuk e njof se nuk kam asnji lidhje, as miqësore, as shoqërore, me Kukë dhe me Dragash. Në atë zonë atje në jetën time ndoshta dy herë jam kanun, mbrenda këtyne 20 vjetëve të fundit. Nuk njof kurrkënd.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kiji parasysh këto dy emra, pra, Naser Arifi nga Kuka, dhe të Fetahut, po nga Kuka.

Tani shkojmë në faqen -- 6593, dhe në shqip është 6594.

Këtu thuhet që:

"Ka tre fletë-arreste për..."

Tri personat që janë këtu. Personi në numrin dy, a është personi që keni përmendur ju më përpara, një person që ju e njihnit?

PË. Po, i njëjti është ky, po.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini pse duhet të kishte një fletë-arrest për të në korrik të 1998?

PË. Unë s'e kuptoj. Për mua është një njeri shumë i mirë dhe ka qenë i mirë edhe para luftës, gjatë luftës, pas lufte. Nuk e di kush e ka regjistru, si duket ma tepër janë ba këto për hakmarrje personale ose hakmarrje të konflikteve para lufte ose urrejtje s'ka të bëjë me -- absolut. Këta dy të tjerët nuk

po i njof.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I kthehemi dokumentit me P711 MFI.

Dua t'i kthehemi edhe një herë dokumentit që ju tregova para një çasti, tek ai dokumenti ku identifikuat pesë personat që ju besonit se kishin bashkëpunuar me Serbinë.

Shohim numrin 1 në këtë listë. Kemi emrin Osman Fetahu nga Kuka këtu. A besoni se është i njëjti person që diskutuam pak para një çasti?

PË. I njëjti duhet me qenë se Kukë, Kukë edhe atje shkrunë, dhe këtu. Kuka, Kukë. Njëjtë është. Vetëm është Kuka kur thojnë për Kukën, kur thojmë Kukë, vendin Kukë. Domethënë e njëjta është.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faqen tjetër, që është me numrin 7855. Shohim, shihni numrin 35. A duket të jetë i njëjti person që diskutuam para një çasti dhe ky? Naser Arifaj nga Kuka?

PË. Jo, i njëjtit vend, por jo i njëjti person. Ndoshta është ai Naseri atje që pamë, po. Po, po. Në atë tjetrën fletë, po. I njëjti është.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim faqen tjetër. Jo, desha të thoja në faqen e fundit të dokumentit. Një faqe më përpara, ndjesë edhe një herë.

Këtu te numri 61, e konfirmoni që është i njëjti person?

PË. Po, po. Ky është i Zhurit, Ulusi Badallaj, Zhur. Po, i

njëjti person është. 61-shi.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në faqen 7855 në të njëjtin dokument. Ju lutem, shihni emrat 36, 37. Hasan, babai, emri i babait Rrustem, Krasniqi, agjent dhe Nezir Sahitaj nga Qifllaka. E shihni këtë?

PË. Po, i shof.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini, a e njihni ndonjë prej këtyre personave?

PË. Jo, nuk i njoh, si emër. Hasan Rrustemi e di që është i vramë pas lufte. Është i vrarë. Nuk e di kush e ka vrarë, por e di që ka pasë nji shkrim, nji njoftim nëpër gazeta atëherë bile edhe gazeta kemi pasë hala. Tash ma gazeta nuk dalin në Kosovë. Hasam Rrustemi është i vrarë diku në Xërxë, apo -- në Xërxë, po. Në Xërxë. Pazar ka qenë.

Këtë tjetrin, Nezir Sahitaj, nuk e njof.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër. Shihni numrin 41, ju lutem, Pal Morina. Nuk e them dot emrin e fshatit, por e njihni këtë person?

PË. Jo, nuk e njof. Është i rrethinës, fshati është i rrethinës së Gjakovës. Anës së Dukagjinit, a duhet me jua thanë, a s'duhet? Ndoshta dhe unë nuk duhet me ja thanë fshatit emrin, s'e di, veç, nuk e njof Palin. Pal Morina, jo. Nji Pal Palucaj është hero, atë e njoh. Këtë nuk e njoh.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I kthehemi provës materiale P651 MFI. I njëjti bllok shënimesh që ju tregova pak

1 më përpara.
2 Do i lutesha Zyrës Administrative që të shkonim në faqen
3 6569 tek anglishtja dhe besoj se shqipja është me numër 6570.
4 Besoj se shqipja duhet të jetë faqja tjetër. Faleminderit.
5 A mund ta shihni -- tek shqipja, është një emër Hasan
6 Rrustem Krasniqi. Është me vizë poshtë, e shihni këtë emrin?
7 PË. Po, po, e shoh. Më mirë lexohet tek anglishtja, i njëjti,
8 është i njëjtë.
9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Duket të jetë i njëjti
10 person, si ai që pamë dhe në dokumentin tjetër?
11 PË. Po, për të njëjtin person. Për të njëjtin person flitet.
12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër.
13 Këtu flitet për Azem Berishën, që ka qenë "hajn e ka
14 bashkëpunu me shkitë", "jeton në Bajram Curr tek shtëpia e
15 Nezir Sahitit".
16 E shihni këtë?
17 PË. Po, e shof.
18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është ky i njëjti person
19 që pamë, i njëjti Nezir Sahiti që pamë tek lista më përpara?
20 PË. Nuk e di, nuk jam i sigurt. Ne e pamë një Azem Berisha
21 atje, por këtu thotë paska qenë hajn, atje si duket ishte në
22 listën e spiunëve. Nuk e di kush, çka kanë bo -- nuk e di,
23 mund të jetë i njëjti.
24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kalojmë tani në faqen 6574
25 në anglisht dhe 75 përfundon në shqip. Këtu pakëz më poshtë në

shqip, faleminderit. A mund të gjeni një pasazh që fillon me fjalën B. Gashi? Thotë:

"B. Gashi

"Raport të ngushtë me Skënder Kryeziun, anëtar i Shoqatës së Gjuetarëve të Prizrenin, mban armë me leje nga SPZ-ja e Prizrenit.

"Ka pasur dhe ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me vëllezërit Qesko, të cilët dyshohen për aktivitete të dyshimta muajve të fundit në lagjen e Tusuzit..."

Ju e njihni Bajram Gashin?

PË. Jo, nuk e njof. E njof Bajram Gashi tjetër, tjetërkush, është kanë luftëtar dhe i burgosun politik. Këtë nuk po e njoh, por paska pasë armë me leje prej shërbimit të punëve të mbrendshme të Serbisë. Sigurisht kjo ka konstatue se paska qenë bashkëpunëtor me ta. Por unë nuk e njof, dhe nuk e di kush e ka bë këto shënime. Shumë shkrimi i ngarkumë i zorshëm dhe me e lexu. Këtu në këtë rast po lexohet.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kalojmë tani në faqen tjetër, ju lutem. Numër 7856. këtu thuhet se:

"Z. Bashkim Krasniqi, biri i Xhemës, mund të dëshmojë për aktivitetin e tij.

"Po kështu B. Gashi ka kontakte edhe me Pal Morinën, pronarin e kafeterisë Tifan në Prizren, në Basni [fonetikisht]."

A duket ky sikur është ai personi që pamë në listë, më

duket në -- me numrin 61, para pak.

PË. Kjo si duket është lidhja e njëjtë, B. Gashi. I njëjti Bajram Gashi, po kush janë këta që kanë nxjerrë kaq konkluzione kështu, nuk e di.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po kështu më tej po në atë faqe thuhet për Hasan Krasniqin, birin e Rrustemit, që e pamë para pak.

PË. Po, i njëjti është, i njëjti.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mund ta heqim këtë dokument tani, faleminderit.

Ju lutem, kalojmë tani te prova numër P711, pra P711 për një çast. Faqen e fundit, ju lutem. Faqja tjetër, ju lutem.

Mund të shihni, ju lutem, djathtas poshtë, te faqja në shqip, a e vini re që ka një firmë aty, një nënshkrim?

PË. Po, e kemi pa dhe atë ditë këtu para kur isha ma herët në seanca të tjera. Nuk munda ta dalloja nënshkrimin tamam. Kjo ishte në listën e përbashkët me ata emrat të cilët i identifikova ma herët.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ka një datë aty, 1998, apo jo?

PË. Po, 1998 shkrun.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Emri që shihni aty, pra aq sa mund ta shihni, a mundet thua të jetë Berisha?

PË. Po, pjesa e dytë po. Por kjo shkronja e parë nuk e di. Pjesa e dytë, Berisha, mund të jetë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] T'jua pyes kështu. Në korrik të vitit 1998, brenda asaj që do të quhej më pas zona e Pashtrikut, sa Berisha njihnit ju që funksiononin në ZKZ, shërbimi informativ apo S2, sa Berisha njihnit?

PË. Berisha shumë njoh, por në ZKZ s'njoh. Në ZKZ përmendëm më herët Skënder Berisha. A mund të jetë ky Skënder Berisha? Nëse mund të jetë ky. Përndryshe, nuk njoh.

GJYKATËSI METTRAUX: [Nuk ka përkthim]

PË. Po s'është -- se ajo nuk del. Berisha po del tamam, 1998, mund të jetë ai.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse ju kujtohet, ju kujtohet Xhavit, pra nofka e Xhavit Berishës asokohe?

PË. Jo, nuk e di kush e ka pasë Xhavit Berisha. Nuk më kujtohet kjo nofkë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jo, ju kërkoj ndjesë. e thashë unë keq pyetjen. A ju kujtohet se cili ishte, se cila ishte nofka e Xhavit Berishës?

PË. Nuk e di kush është Xhavit Berisha. Xhevat Berishën ndoshta e keni fjalën. Xhavit Berisha, nuk e di kush është.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju kërkoj unë ndjesë për shkak të theksit tim. E kam fjalën për Xhevat Berishën, po. A e dini nëse e kishte nofkën Sokoli?

PË. Nuk jam i sigurt, sinqerisht, ai ka ra herët, ka ra në shtator, 1 apo 2 shtator në 1998. S'kena pasë kurrfarë kontakti fizik asnjiherë. As me atë batalionin e tyne, jo veç

me Xhevatin. Sinqerisht, kështu. Ka mundësi [E padëgjueshme].

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, s'e keni dëgjuar kurrë që ta quajnë Sokoli, se keni pa asnjëherë në një dokument ku të jetë shkrujtë Sokol apo Sokoli për atë?

PË. Jo, nuk e kam pa për besë. Nuk e kam pa se s’e kisha harru. Se ai është tash dëshmor, është hero. Do ta kisha mbajtë mend.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t’ju pyes për diçka që, për të cilën keni diskutuar me z. Emmerson, Avokati Mbrojtës i z. Veseli, dhe ka të bëjë me terminologjinë. Dua që të sigurohem që të kemi kuptuar qartë lidhur me këtë temë. Do jap një përmbledhje të asaj që mendoj unë se e keni dëshmuar ju këtu. Nëse është e pasaktë apo e paplotë ju lutem, ndërhyni, thoni.

Deri në një moment të tillë, pra derisa u ngrit Qeveria e Përkohshme e Kosovës, terminologjia e duhur për t’i quajtur ata që bënin zbulim-kundërzbulimin ishte ZKZ, apo kundërzbulim. Kështu e kam kuptuar saktë, mirë e kam?

PË. Po, drejtë e keni, drejtë e keni. Ashtu është.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe gjatë kësaj periudhe, dhe e kam fjalën sërish për QPK-në, ndonjëherë quheshe siç e thatë ju vetë, me numrin G2, J2, S2, kështu?

PË. Jo të QPK-së, të QPK-së nuk kanë pasë kësi kode, por mbrenda UÇK-së -- J2, J1, G1, G2, S1, S2. Kështu, në bazë të rangut. Jo, qeverisë së përkohshme s’ka pasë kësi.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Dhe kur u krijua QPK-ja, emri ndryshoi, emërtimi pra, dhe u bë SHIK, kështu?

PË. Unë për SHIK-un vetëm teoritikisht kam dëgju, as kam pasë ndonjë qasje, as lidhje. As e kam ditë si funksionon. As nuk e kam ditë që Kadri Veseli është shef i SHIK-ut, por e kam ditë kur është shpërbë SHIK-u publikisht që është dalë se nuk funksionon ma, atëherë e kam kuptu që paska vazhdu SHIK-u nji kohë të gjatë. Se Shërbimi Informativ i Kosovës është shërbim, ka qenë shërbim sekret dhe si i tillë unë s'kam pasë qasje në të.

Nuk e di as datën e themelimit, nuk e mbaj mend edhe datën e shpërbërjes, por data e shpërbërjes duhet me u kanë diku kah shpallja e pavarësisë, që atëherë mbas shpalljes së pavarësisë, a para shpalljes së pavarësisë është shpërbë.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju pyes vetëm për terminologjinë, për emërtimet. Pra, pas krijimit të QPK-së shërbimi i zbulim-kundërzbulimit quhej më pas SHIK, kështu?

PË. Po, e drejtë është.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por ajo që kemi parë, edhe mbase e kam gabim, më korrigjoni, nëse do ta them gabim, por kemi parë që një sërë njerëzish, përfshirë edhe Halil Qadrakun, ishin disi të konfuzionuar sa i takon terminologjisë dhe e kanë përdorë emërtimin SHIK edhe në mars të 1999, kështu?

PË. Ju shumë keni të drejtë. Shumica edhe në popull, por edhe në struktura ku kanë ndodhë, kanë mendu që do të jetë shërbimi i përbashkët me të Shqipërisë, apo i ngjajshëm me të Shqipërisë, edhe nuk është ditë fillimisht se a do të shkonte drejt pavarësisë së Kosovës, a drejt bashkimit me Shqipërinë, dhe kanë përdorë terminologjinë të njëjtë me të Shqipërisë. Shumë njerëz e kanë pasë konfuzion këtë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ajo që është konfuzion gjithashtu, nëse mund ta përmbledh dëshminë tuaj, është fakti se njerëzit ndonjëherë këtë fjalën *intelligence* në anglisht, pra e thoshin edhe informatë, informacion, informativ, pra.

PË. Informator, informacion, keni shumë të drejtë, ashtu e kanë qujtun. Informatorët, kuptohet, ata që të japin informacione, por tu mos e ditë se çka do të thotë informacion çka do të thotë informator, çka do të thotë bashkëpunëtor, ose anëtar i strukturave, nuk i kanë ditë këto gjona. Nuk i dinë as sot shumica. Shumë keni të drejtë. Shumë keni të drejtë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, një moment. Ka ngecur transkripti. Për këtë e ngritët dorën dhe ju?

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

[Trupi Gjykues dhe Sekretarja e Gjykatës këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi pranuar rindezje të sistemit.

[REDAKTUAR], nuk e di nëse mund ta plotësoni përgjigjen tjetër. Në rregull.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj se jemi gati për të rifilluar.

Atëherë bëjmë tani pushimin e drekës në mënyrë që të rikthehemi dhe të punojmë siç duhet. Do të rikthehemi në orën 14.30.

Znj. Sekretare, mund të shoqëroni dëshmitarin të dalë.

Dëshmitar, bëni pushimin e drekës. Ju lutem mos flisni me askënd lidhur me këtë çështje gjyqësore.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] këtu bëjmë ndërprerje, deri në orën 14.30.

--- Pauza e drekës fillon në orën 13.18

--- Seanca rifillon në orën 14.29

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem Asistentes të sjellin dëshmitarin në sallë.

[REDAKTUAR], keni diçka për të thënë tani?

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Thjesht për procesverbal versioni i redaktuar publik që u pranua këtë paradite me numrin P680 tashmë kanë marrë numrin e provës materiale P680.1. Pra, versioni i redaktuar publik.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë,

Dëshmitar, do të vijojmë me dëshminë tuaj.

Gjykatësi Mettraux, fjala është për ju.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim]

Mirëdita, Dëshmitar.

PË. Mirëdita.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do doja t'ju pyesja lidhur me policinë ushtarake tani. Më duhet të them që ju i keni dhënë përgjigje palëve dhe kolegut tim, Gjykatësit Barthe, lidhur me këtë temë, por dua të jem i sigurt që e kemi kuptuar tamam atë që po na thoni.

Me sa kuptova unë para dy javësh ju keni sugjeruar, ju keni thënë, pra, se nuk ka pas polici ushtarake brenda asaj që do të bëhej më vonë zona e Pashtrikut në shkurt të '99-s kur u emërua Nexhmedin Krasniqi si shef i policisë ushtarake. Me sa kuptova unë sot i keni dhënë një përgjigje disi të ndryshme Gjykatësit Barthe. Kështu që do ju jap një mundësi tjetër që të na tregoni apo të na thoni dëshminë tuaj lidhur me këtë pikë.

Ju po thoni që askush nuk ka kryer funksione të policisë ushtarake në këtë zonë deri në shkurt të 99's apo jeni përpjekur të thoni diçka tjetër? Pra, ata që kryenin këto funksione nuk ishin strukturuar formalisht në të ashtuquajturën polici ushtarake?

A mund të na shpjegoni si cila është dëshmia juaj lidhur me këtë pikë?

PË. Z. Gjyqtar, as e para as e dytë nuk janë ashtu. Unë thashë se nuk ka pas zbulim dhe kundërzbulim deri në atë kohë. Nuk e kemi pas fjalën për polici fare. Polica është strukturuar pas ardhjes së komandant Nexhmi Krasniqit në zonë. E vetmja është batalioni i Budakovës që ka pas polici. Po më duket e paqartë pyetja ka qenë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, dëshmia juaj është që përveç batalionit të Budakovës ku ishit dhe ju kreu i këtij batalioni, pra, Batalioni i 2-të, nuk ka pasur polici ushtarake brenda kësaj zone deri në shkurt të 1999, këtë po thoni?

PË. Ashtu është.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani do t'ju pyes për dokumentet tuaja dhe më pas do flasim pak më gjerë për zonën tuaj.

I lutem Sekretares të nxjerrë në ekran provën materiale P277, P2722 [sipas përkthimit] - më falni - dhe për procesverbal është me ERN U000-147 [sipas përkthimit].

Dëshmitar, a ju kujtohet që ju kanë treguar këtë dokument gjatë intervistës që keni pasur me ZPS-së?

PË. Po.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nga pamja duket si një urdhëresë, por në fakt në anglisht është "autorizim" që e keni bërë ju, Sadik Halitjaha, 5 shtator 1998 është data edhe është i drejtohet -- del nga policia ushtarake, shtabi i Budakovës

të bëjë grumbullimin e armëve për UÇK-në në fshatin Grejkovc. A jeni ju autori i këtij dokumenti?

PË. Po.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është vërtet një autorizim apo një urdhëresë që keni nxjerrë ju për policinë ushtarake që të kryente një detyrë, gjegjësisht që të grumbullonin armët?

PË. Ju faleminderit shumë për pyetjen. Do ta sqaroj nëse keni durim edhe jam mirënjohës që e nxorët në ekran dhe që po shqyrtohet kjo.

Kjo është lëshuar për fshatin Grejkoc që ata ta dërgojnë në policinë jugosllave, ta futin në batauletin e tyre në postën e tyre. Bile i kam këshillue me dorëzat janë që të mendojnë policia jugosllave se ne i kemi mbledh armët e fshatit Grejkoc, përndryshe ata torturonin fshatin Grejkoc, Dubravë, Sallagrazhdë dhe i mblidhnin armët me dhunë nga populli.

Kjo ka qenë shpëtimi nga dhuna e fshatit Grejkoc. Nuk është për policinë e UÇK-së, por është për policinë jugosllave një autorizim i imi, gjoja sikur unë i kam mbledhën armët e këtij fshati që s'është e vërtetë, s'kam pas nevojë me i mbledh. Ata i kanë pru vetë; kanë ardhë me gjithë armë atje tek unë ushtarë janë konë.

Shumë po më vjen mirë që po sqarohet kjo se vërtet e kanë bë konfuze. Shumë është e saktë tash.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Që ta përmbledh dëshminë tuaj, nëse e kam kuptuar unë siç duhet ky dokument nuk është ai që duket, është një urdhër i rremë për sekuestrim të rremë të armëve që ju e keni përpilu në mënyrë që të çorientonit serbët, e kam kuptuar saktë?

PË. Saktë, të shpëtohet ajo popullatë dhe mos t'ia kërkojnë serbët, mos t'ia kërkojnë policia serbe. Saktë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në dëshminë tuaj shtabi i Grejkocit duhet të shkonte te shërbimi postar jugosllav dhe të postonte këtë dokument për dikë, domethënë ta çonte me postë?

PË. Jo. Kushdo qoftë prej, kushdo qoftë prej fshatarëve të Grejkocit ta futë tinëzisht në postën e policisë që të mos verifikohet kush e ka futë; kam këshillu të kanë edhe dorëza dhe policia ta shef si unë e kam marrë, i kam marrë armët që mos t'i ngarkojë, mos t'i rrahë fshatarët, mos t'i torturojë.

Dy kësi vendime kanë qenë; dy herë më kanë kërku: të parin që i kam grumbullu; të dytën që i kam kërku nuk e di veç dy raste e di që kam lëshu për Grejkoc për fshatin Grejkoc. Sepse kanë qenë të torturuar të gjitha shtëpitë, gjithë familjarët e tyne.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju shpresonit që në mes të luftës në Kosovë dikush do ta vendoste këtë urdhrin tuaj tek zyra postare edhe aparati i sigurisë serbe ta gjente, kështu?

PË. Në këtë mënyrë dhe për këtë qëllim është bë kjo edhe mendoj që kam bë një shërbim të madh popullatës të asaj ane.

Megjithëse dhe ashtu kanë dorëzu pak armë se dhuna dhe presioni serb ka marrë armë nëpër shumë fshatra.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mund të shohim Provën Materiale P723.

Ky në titull thotë, certifikatë në anglisht. Duket të jetë një raport për zbatimin e urdhrit që sapo pamë. Kështu duket nga pamja.

PË. Për këtë e kisha fjalën që ishte e dyta, sepse ata frigoheshin se kur do t'i pyesin sa armë keni dorëzu, kujt ia keni dorëzu, kush i ka marrë nga UÇK-ja, kjo arsyeton vendimin e parë. Është vendim, te na quhet vendim, e autorizon atë të parën, domethënë, e arsyeton atë të parën, e arsyeton. Edhe këtu saktësisht kena marrë kaq, kaq. Nuk janë të saktë; janë shifra imagjinare për të mos i lënë ata në tortura që me iu kërku atyne.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, sipas dëshmisë suaj është pjesë e njëjtës, po themi, në mënyrë tinëzare të çorientonit aparatin serb të --

PË. E njëjta, e njëjta.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe një nga fshati, p.sh. do shkonte te kutia postare diku do ta hidhte në kutinë postare që ta gjenin serbët, kështu?

PË. Kështu dhe ka qenë dhe jam shumë i lumtur që kam arrit me shpëtu pak a shumë prej torturave. I kam thonën, çka do që t'ju thojnë, thuni që i ka marrë UÇK-ja dhe mos thoni që kemi

dorëzu vullnetarisht, por me zor na i kanë marrë, me qëllim që t'i lehtësojmë ata nga torturat.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por sidoqoftë ju mbajtët kopje të këtyre dy dokumenteve në arkivën tuaj, apo jo?

PË. Kemi mbajt kopje, por nuk e di a e kam a jo. Shumë me dëshirë e kisha pas me rujt.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të shohim Provën Materiale P303.

Kjo është një artikull nga *Zëri i Kosovës*, 5 nëntor 1998. Shkojmë te faqja tjetër ju lutem, tek anglishtja. Edhe shqipja në të njëjtën faqe duhet të jetë.

E shihni në krye të faqes një artikull që është kumtesa numër 4 e Drejtorisë së Policisë Ushtarake të UÇK-së, e shihni në ekran?

PË. Po, po e shoh, e shoh.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Duket si një kumtesë, kumtesa numër 4 e Drejtorisë së Policisë Ushtarake të UÇK-së, data 1 nëntor 1998 në Prishtinë dhe i atribuohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës -- Policisë Ushtarake të UÇK-së.

Po ju jap një moment që të njiheni me përmbajtjen. Ju lutem lexojeni dhe më thoni kur të keni mbaruar.

PË. Unë e lexova. Me dy çështje nuk jam dakord fare. Më 4 dhjetor nuk ka pas polici ushtarake dhe përmbajtja e krejt kësaj çka është për mua është shumë e panjohur, për herë të parë po e shoh. Unë në atë kohë kam qenë akoma në batalionin e

Budakovës nga fundi i dhjetorit, domethënë, prej 15 dhjetorit e mbrapa kam qenë në nivel të zonës këndej. E çuditshme, për mua për herë të parë po e shoh këtë dokument.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju në fakt u përgjigjët pyetjes së parë. E para është që ju nuk e njihni këtë kumtesë, apo jo?

PË. Jo, jo, jo.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po me incidentin, konkretisht me arrestimin e dy veprimtarëve të LDK-së, Cen Desku dhe Jakup Kastratin, keni dijeni për këtë?

PË. Nuk kam dijeni e s'kam pas asnjëherë për këtë. Remzi Hoxhaj kam dëgju diçka një proces gjyqësor është në Prizren si emën kom dëgju. Kurrgjë s'kam ditë në atë kohë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kumtesa i atribuohet policisë ushtarake të UÇK-së, keni dijeni të ketë ekzistuar drejtoria e policisë ushtarake të UÇK-së në nivel të Shtabit të Përgjithshëm në nëntor të vitit 1998?

PË. Jo, veç që nuk kam dijeni, por edhe nuk ka teoritikisht nuk ma rrok ajo që mund të ketë ndodh me pas drejtori të policisë në atë kohë. Më vonë po, aman në këtë kohën nuk -- nuk ka pas -- unë nuk di që ka pas. Dikush e ka bë, ndoshta në emër të policisë për me frikësu dikën apo me ndiku diçka të veçantë veç realisht nuk ekziston.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj. E shihni paragrafin e parë në dokument ku thotë:

"Policia Ushtarake e nënzonës Operative të Pashtrikut më 30 tetor 1998 arrestoi" dy persona në fjalë.

Keni ndonjë dijeni për këtë?

PË. Gabimisht ose qëllimisht është e shkrume kështu. Nuk ka pas nënzonë në atë kohë. Nënzonat kanë fillu nga fundi i nëntorit, zona u kriju në janar. Nuk ka pas nënzonë, nuk e di pse ka marrë këto emrat të mëdhenj dikush për me frikësu dikën ose për me bë ndikim psikologjik a propagandistik, nuk e kuptoj pse kështu.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jam më i interesuar në aspektin e policisë ushtarake se këtu thuhet që ka pas polici ushtarake në zonën e Pashtrikut në tetor të '98-s. Dhe kjo nuk përputhet me dëshminë tuaj.

PË. Për atë po më duket e çuditshme se nuk ka pasur, nuk ka pasur, por për çka është shkru në këtë formë shkruesi i kësaj ka pas qëllim të caktuar qoftë propagandistik qoftë të frikësimit se ekzistojka diçka e tillë edhe e ka bë në emër të asaj, i ka vu emër realisht nuk ka ekzistu. Unë nuk jam në dijeni së paku edhe është konë dashtë me ditë a ekziston a jo.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po vetë ju thatë që nuk keni dijeni kush i ka arrestuar këta dy persona. Ju nuk e dini.

PË. Jo, nuk e di, por nuk e di as kush e ka shkru këtë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtu thuhet:

"Në bazë të të dhënave të shërbimit informativ të UÇK-së

për veprimtarinë e tyre kundër luftës çlirimtare të UÇK-së...". E kështu me radhë vazhdon.

Pyetja ime është kështu: keni dijeni që arrestoheshin persona nga policia ushtarake në vitin 1998 në bazë të të dhënave të shërbimit informativ apo as për këtë nuk keni dijeni?

PË. Nuk kam dijeni edhe këtu në dokument i shoh se në Prishtinë është shkru ky. Prishtinë 1 nëntor 1998. Dikush ka lëshu komunikatë nga stacioni i trenit a i autobusëve atje në Prishtinë. Qëllimisht është bë kjo ose u bë prej pavetëdije ose qëllim frikësimi, unë nuk e di. Nuk jam në dijeni për këtë. S'jam në dijeni.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull.

I lutem Sekretares të vendosë në ekran dokumentin me numër ERN 083227-083248-ET.

Dëshmitar, ky është një raport që është përgatitur e përpiluar nga komandanti -- ndihmëskomandanti i Brigadës 123 Sabri Emerllahu - më falni - Ymerllahu, e njihni këtë person?

PË. Duhet të jetë me emër Sadri Emerllahu, Sadri Emerllahu, por nuk besoj që ai e ka bë këtë. Ta shof, as s'ka datë të shkrume as, çfarë ka dasht me thënë aty.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mund të shohim faqen 13 që ka numrin e ERN-së 083239. Me sa kuptoj, ju kuptoni pak anglisht.

PË. Pak. Frëngjishten e kuptoj mirë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E shihni i atribuohet Sadri, domethënë, pretendohet që kjo -- thuhet që kjo ka dalë nga Sabri Emerllahu, a e shihni, Sadri - më falni - Sadri Emerllahu?

PË. Sadri, Sadri, po e shoh, e shoh.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I kthehemi faqes së parë. Në fund të faqes. Unë do ju pyes këtë: Më përpara e keni parë ndonjëherë këtë raport që ka përgatitur z. Emerllahu?

PË. Jo, jo, jo. Me pas qenë komandanti i brigadës ndoshta kish raportu në zonë e kisha pa. Por ky për kën e ka bë këtë raport nuk e di.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na thoni çfarë funksioni apo funksionesh kishte në zonën tuaj në vitin 1998?

PË. 1998 ka qenë në nivele të batalioneve krejt komplet deri në fund të vitit. Nga fundi i vitit kanë fillu të kompletohen strukturat e brigadave dhe të formohen nënzona ose zonat. Zonat janë formue në fillim të janarit 1999. Kështu ka qenë zhvillimi i UÇK-së në zonën time.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Paragrafi i fundit thuhet kështu:

"Si rezultat dhe si pasojë e punës së madhe që është bërë në terren dhe nevojës për të unifikuar faktorin ushtarak të brigadës -- u formua Brigada 123 e UÇK-së. Me shkrirjen e këtyre dy njësiteve...".

Shkojmë te faqja tjetër.

"...më 15 qershor 1998 formohet Brigada 123 e UÇK-së në zonën e Suharekës me këtë strukturë komandimi -- komanduese".

Së pari, a është e saktë që Brigada 123 është formuar më 15 qershor 1998?

PË. Jo, nuk është e saktë, është formuar më 26 qershor. Se të njëjtën datë është formu dhe Batalioni e 2-të në Budakovë. Unë nuk kam ndodhë aty kur është, kur janë bashku këto dy grupime. Kam ndodhë në Budakovë. Atje kam themelu batalionin e 2-të me 26 qershor, domethënë, është themelu, gabim është data. Është i përgjumshëm pak ky Sadria.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më pas paraqitet dhe struktura: Blerim Kuqi u emërua komandant brigade; zëvendëskomandant brigade, Habib Elshani; shef shtabi, Agim Kuqi; ndihmëskomandant për zbulim e kundërzbulim, Ilaz Kadolli; ndihmëskomandant për logjistikën, Ruzhdi Gashi; dhe ndihmëskomandant për policinë ushtarake, Isuf Krasniqi.

PË. Deri këtu ku i lexuat këta, z. Gjykatës, të gjithë këta kanë dezertuar me 22 gusht '98. Vërtet janë strukturë e komandës të brigadës të themeluar si komandë, por nuk ka qenë e kompletuar krejt me batalionet, me strukturat të tjera.

Këtu në këtë shkrim ku shihet Ilaz Kadolli nuk e di sa e ka ushtru këtë detyrë prej 26 qershorit deri më 22 gusht, kjo strukturë ka qenë siç e shihni ju, ka qenë e Brigadës 123 dhe të gjithë këta çka janë këtu këta emra kanë dezertuar; kanë ik në Shqipëri me 22-23 gusht 98.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] T'i marrim me radhë. A pajtoheni që në qershor, ai thotë 16 ju thoni 26, pra --

PË. -- 26, 26 ju garantoj me jetë. 26 se të njëjtën ditë i kemi themelu. Unë Batalionin e 2-të -- Sadria ka qenë me mu. Sadri Emerllahu ka qenë me mu në Batalionin e 2-të, nuk ka qenë në brigadë. Më vonë ka ardhë në brigadë kur u kriju zona. Gabim e ka, sigurisht pa dashje ku e di unë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, a pajtoheni, pra, që në qershor të '98-s, nuk ka rëndësi cila datë, një ndihmëskomandant për policinë ushtarake emërohet, pra, Isuf Krasniqi, emërohet zëvendës - më falni - ndihmëskomandanti për policinë ushtarake. Pajtoheni me këtë apo nuk pajtoheni?

PË. Po, z. Gjyqtar, pajtohem se kam dokument kur është themeleu kjo. Kështu është e saktë, por është 26 qershor.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim paragrafin e fundit në të njëjtën faqe. Z. Emerllahu thotë:

"Njësitë në Shtabin e Përgjithshëm po ashtu i riorganizuan në seli, njësitë në seli po ashtu organizuan dhe filluan funksionimin normal në të gjithë territorin që mbulonte kjo brigadë. Policia ushtarake po ashtu funksiononte pranë këtyre njësiteve në seli".

A e pranoni ju faktin që kanë ekzistuar policia ushtarake në nivel brigade në atë kohë sipas kësaj dëshmie?

PË. Jo, jo, jo s'ka teori fare.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sepse sipas jush kjo ka

ndodhur muaj më vonë --

PË. Më vonë, më vonë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] -- në vitin 1999.

PË. Ai i ka përzi veç etapat i ka përzie. Ka thënë diçka të vërtetë, por etapat i ka përzi.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj.

Shohim faqen tjetër të të njëjtit dokument. Nuk jam i sigurt pse nuk po ju tregojmë dhe versionin në shqip. Po duhet të ketë dhe version në gjuhën shqipe me të njëjtën numër ERN-je.

PË. Edhe kështu edhe kështu unë i besoj ato çka na thoni ju edhe e shoh pak a shumë e kuptoj.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë në qoftë se doni që t'ju shfaqim edhe versionin në shqip na thoni, sepse e kemi. Unë po ju lexoj ndërkohë anglishten.

PË. Nuk ka -- veç vazhdoni ju në anglisht.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Paragrafi i parë në këtë faqe thotë:

"Pas përgatitjeve themelore, pas - më falni - pas përgatitjeve në bazë Batalioni i 2-të me seli në Budakovë formohet saktësisht më 26 qershor 1998. Pra, përputhet kjo me të njëjtën gjë që ka thënë edhe z. Emerllahu për formimin e batalionit tuaj, kështu?

PË. Kjo përputhet tamam kështu në këtë datë e tash po e kuptoj pse e ka thënë atë datë më herët ai. Ka dashtë që t'ia

le meritat se ka pasë batalion tjetër më përpara në Brigadën 123, por nuk ka pas. Pas kësaj date themelohet Batalioni 1-rë ku qëndron edhe selia e brigadës. Batalioni i 2-të është njësia e parë në Therandë në Suharekë që është themelu. Data është e saktë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më pas vijon:

"Këtu, edhe pas organizimit intensiv të këtij batalioni vazhdoi përgatitja. Sadik Halitjaha emërohet komandant i këtij batalioni".

Dhe më pas rendit një sërë personash edhe rolet e tyre përkatëse. E konfirmoni, a është e saktë apo e pasaktë kjo?

PË. E saktë është, e saktë vetëm shihni këtu emri i Sadri Emerllahut ku del që është në Batalionin e 2-të në Budakovë edhe ka shkru diçka ku s'ka qenë fare atje. A e kuptoni? Shihni këtu ku del në rreshtin e parë, në këtë rreshtat e ndara. Zëvendëskomandant a çka ka paraqit veten shef, Sadri Emerllahu.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më intereson këtu pjesa për Musli Kolollin që paska qenë komandant i njësitit të ndërhyrjes edhe togës së policisë ushtarake pranë batalionit tuaj, e saktë është kjo?

PË. Po, por kjo është bë më vonë. E saktë është, por është bë më vonë. Nuk është bë baras me themelimin e batalionit. Është bë më vonë. Në fillim është kriju një skuadër për intervenime të shpejta, më vonë ajo skuadër u shndërrua në policë

ushtarake, më vonë janë bë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe kjo e fundit ka ndodhur në gusht të ’98-s ku z. Xhemajl Rexha u vra, apo jo? Atëherë pasi u vra ai mori përsipër Musli Kololli detyrën e policisë ushtarake, kështu?

PË. Edhe Xhemajl Rexha nuk ka qenë në polici ushtarake. Ka qenë komandant i kompanisë së 1-rë është vra me granatim me datën 23 gusht, me datën 23 gusht të 1998.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e pranoni që z. Rexha ka qenë ai që kryente funksionet e policisë ushtarake deri në momentin e vrasjes së tij në gusht të ’98-s?

PË. Jo, jo, s’ka pasë, s’ka pasë polici, s’ka pasë polici.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ju lexoj atë që ka thënë Musë Kololli dhe ju kërkoj të komentoni. Ai ka thënë:

“Unë u kyça” --

Për procesverbal është materiali me numër SITF0032827. Është deklarata e Musë Kolollit.

“Iu kyça UÇK-së më 15 korrik 1998...”.

Po e heq një fjali këtu. Pastaj thotë:

“Pas vrasjes së komandantit lokal të policisë ushtarake në Budakovë, Xhemajl Rexha në vitin 1998, unë mora përsipër detyrën e tij.

Më 24 gusht të ’98-s u bë një betejë e madhe në regjion në fshatin Semetishtë dhe në disa fshatra të tjerë. Një javë më përpara, më konkretisht 15 deri në 17 gusht të ’98-s

policia, Mus Qerkini i policisë ushtarake që jetonte në fshatin Savrovë rreth orës -- ...".

Edhe tregon pastaj një incident që ka ndodh nga ora 09.00 a ora 10.00. Pra, sipas dëshmisë që ka dhënë z. Kololli ai ka marrë përsipër detyrën e policisë ushtarake nga z. Rexha dikund nga mesi i gushtit '98-s, a kundërshtoni këtë?

PË. Jo, nuk është kjo e saktë. E saktë është që nga fundi i gushtit e ka marrë detyrën, por jo nga Xhemajl Rexha. Xhemajl Rexha kur është vra ka qenë komandant i kompanisë së 1-rë. Mbas vrasjes së Xhemajl Rexhës komandant i kompanisë së 1-rë u bo Isë Morina. Ky e ka gjetën një njësi të gatshme për një skuadër të policisë dhe pikërisht m'u ka dashtë ky njeri nëpërmes këshillit të fshatit e kanë lypën, ka qenë zëvendëskomandant i policisë në Prishtinë gjatë regjimit të kalum jugosllav; ka qenë me përvojë dhe ka ardhën në fshatin e vet në Budakovë. Është kyçë kur ka ardhë në fshat menjëherë e kam emëru këtë komandant policie dhe që atëherë themelohet policia e batalionit të Budakovës, skuadra e policisë.

Ky ka qenë komandanti i skuadrës së policisë, po ky nuk e din prej kujt e ka marrën atë skuadër se ajo nuk ka funksionu më përpara. S'ka qenë si polici [e pakuptueshme].

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ju kuptova saktë këtë që sapo thatë ju që ishit ju. Prit më duket se thatë në fund të gushtit '98 e emëruat Musë Kolollin që të -- si shef, domethënë, i policisë ushtarake në batalionin tuaj, kështu?

PË. Po, po dikun nga 20 gushti, po nuk di datë të saktë, po në këtë kohë është emëru.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pastaj do të ishte e saktë të thoshim që e ka kryer këtë funksion gjatë gjithë verës së vitit '98 deri në vjeshtën, duke hyrë dhe në vjeshtën e vitit '98?

PË. Unë mendoj që e ka kry tanë kohën këtë funksion derisa janë kriju zonat, nuk e di pastaj ku u emëru diçka dhe u emëru për edukim, trajnim të policisë ushtarake apo nuk di masanej se çfarë ka bë. Se unë nuk kam qenë në Budakovë pas nëntorit '98-s.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ta verifikojmë bashkë. Musë Kololli a nuk u ngrit në detyrë si shef i policisë ushtarake në nivel brigade dikur nga fillimi i tetorit të vitit '98?

PË. Më vonë ndoshta po, jo në atë kohë. Më vonë ndoshta, po. Edhe pas kësaj është marrë si instruktor për ushtrimin e policisë ushtarake. Nuk di diçka ka pas edhe një funksion tjetër më vonë.

Ndërsa në liri, pas çlirimit ka qenë zëvendëskomandant i jugut për Prizrenin. Tani është në pension.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E kuptoj raportin tuaj dhe po të jetë nevoja mund ta lexoj por është me numër SPOE00226697 ku siç e kuptoj unë aty sugjerohet që ai është emëruar në atë pozitë dhe kam fjalën si shef i policisë

ushtarake në nivel brigade dikur nga tetori i vitit ’98. Domethënë, përpara se ju të mos ishit më shefi i batalionit, komandant batalioni. Pra, a përputhet kjo me kujtesën tuaj, me atë çka ju kujtohet?

PË. Mund të ketë ndodhur, nuk jam shumë i saktë, nuk jam shumë i saktë, por më duket që herët është në këtë kohë. S’ma merr mendja ai që ka shku në brigadë. Në brigadë ai ka shku në nëntor a në fund të nëntorit edhe nuk ka pas mundësi ai të bëhet shef i policisë atje kur s’ka pas polici ala. Akoma s’ka ekzistu.

E hershme është data e tetorit. Këtë e di

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndonjë dokument që do të sugjeronte që ai ishte në këtë pozitë në tetor apo -- dhe ose nëntor të vitit ’98 ju do ta kundërshtonit si të pasaktë, kështu?

PË. Unë nuk kam dijeni. Nuk e di.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t’ju pyes për një tjetër individ për të cilin ju ka bërë pyetje Avokati i Mbrojtjes së Thaçi. Është personi i quajtur Blerim Kuqi. Ju kujtohet që ju kanë bërë pyetje për këtë?

PË. Po.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe do të ishte e drejtë, nëse do të thosha, që siç e keni kuptuar ju, siç e dini ju z. Kuqi, Blerim Kuqi e ka dezertu pozitën e tij si komandant brigade?

PË. Po.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe se asokohe do të ishte e drejtë të sugjeroj që kjo do të përbënte shkelje të rregullave të UÇK-së?

PË. Po, konsiderohej dezertim.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini nëse është arrestuar dhe ndaluar z. Kuqi për këtë shkelje?

PË. Jo, nuk e di që është arrestuar. Është folur për këtë gjë dhe ai e ka mohuar vetë. Unë nuk e di, nuk kam njohuri, sepse me gjithë z. Kuqi ka qenë krejt stafi i Brigadës 123. Do të kisha dit edhe për ata të tjerët.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të shohim nja dy dokumente për këtë. Është me numër SPOE00248507-ET dhe i njëjti numër ERN për versionin shqip. Lexojeni një çast dhe ma bëni me dije nëse keni arritur ta lexoni deri në fund të ekranit që ta kalojmë pak më tutje.

PË. Mund të jetë dokument i saktë, por nuk paska nënshkrim dhe s'paska as vulë. Dhe nuk e di sa ka pasë të drejtë këtë ta shkruajë këtu emrin e vet Fatmir Limaj deri sa ka qenë Sokol Dobruna sa e din këshilltari juridik në Shtabin e Përgjithshëm. Sokol Dobruna, jo Fatmir Limaj. Fatmir Limaj në emër të policisë thotë, nuk e di. S'e kuptoj. Nuk jam në dijeni, nuk e kam pa kurrë përpara këtë dokument.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] T'i marrim hap pas hapi dhe sigurisht mund të na thoni dhe çfarë dini, çfarë nuk dini.

E para, jeni -- a pajtoheni se ky është një dokument që vjen nga policia ushtarake siç nënvizuat edhe ju me numër, ka një numër 5/99 i datës 16 janar '99 dhe është nënshkruar nga Fatmir Limaj. Nuk ka nënshkrim fizik siç thoni ju, por i caktohet sikur e ka nënshkru ai. A pajtoheni deri këtu?

PË. Kështu siç e thoni ju, kështu duket edhe e shoh, por derisa nuk e shoh nënshkrimin e tij as ka vulë as, ka një numër protokollimi nalt por nuk -- e kam pa këtë dokument edhe nuk e njoh. Nuk e njoh.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pajtoheni sërish se kështu siç duket në pamje të parë, pra, në pamje të parë është një vendim paraburgimi për Blerim Kuqin nga Suhareka për një periudhë tri-ditore duke fillu prej datës 16 janar '99 e duke përfundu më datë 18 janar '99.

PË. Unë pajtohem plotësisht me shkrimin. Shkrimi është shumë i qartë, i punum drejt, por nuk e di se ka qenë i ndalum edhe sa ka qenë i ndalum. Pyetja që iu ka bo publikisht Blerim Kuqit ka thënë, s'kam qenë i ndalum. Tash a me i besu kësaj apo Blerim Kuqit nuk e di.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pas pak do vijmë aty. Po fillimisht pajtoheni nëse do thoshnim përgjithësisht që policia ushtarake do ta -- duhej ta kishte pas autoritetin për me paraburgos dikë që akuzohej për dezertim si rasti i z. Blerim Kuqi, pajtoheni deri këtu?

PË. Nuk e di që ka pas autorizim të tillë policia ushtarake

dhe nuk njoh rast tjetër që ta krahasoj. Nuk njoh ndonjë rast që ka marrë policia ushtarake, ka burgos për çështje dezertimi. Nuk njoh rast. Dokumenti është shumë i qartë. Ju siç e thoni, ashtu është. Amo unë nuk e kam pa, nuk e njoh këtë dokument.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ta pyes, ta bëj pyetjen ndryshe: Nëse një anëtar i batalionit tuaj apo një anëtar tjetër i UÇK-së kryente ose një shkelje disiplinore apo një vepër penale si ky rast, kush e kishte përgjegjësinë ta -- paraburgoste, policia ushtarake apo dikush tjetër?

PË. Tek unë po të them konkret në batalionin e Budakovës nuk kemi pasë as urdhër as të drejtë me ndalu kërrkënd. Atë e kisha me ditë unë se unë kam qenë komandanti i batalionit; nuk kemi pasë njerëz të ndalum; nuk kemi pasë njerëz të arrestum. Sigurisht ndonjë problem me bë një ushtar e kanë sjellë ushtarin, e kemi çarmatos, më së shumti që kena mujt me shti me bo punë të kuzhinës, diçka për një kohë të caktume me ia marrë armën, me ia hek emblemën, këto kanë qenë masat.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, dhe e kuptoj që s'kishte raste të tilla në zonën tuaj, por -- nëse duhej marrë dikush do e fut dikush brenda do t'i kërkonit policisë ushtarake një gjë të tillë, apo jo?

PË. S'e njoh këtë praktikë. Ndoshta mund të jetë ashtu.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të pajtoheshit besoj se në pamje të parë ky dokument është një tjetër shembull i

funksionimit të policisë ushtarake brenda zonës së Pashtrikut përpara emërimit të Nexhmedin Krasniqit në shkurt të vitit '99, pajtoheni, pra, siç e tregon ky dokument?

PË. Siç e tregon ky dokument është para se me ardhë Nexhmedin -- Nexhmi Krasniqi, por ka mundësi si grup apo si individ apo si s'di si ta shpjegoj, paska qenë dikun në Shtab të Përgjithshëm a jashtë Shtabit që paska punu në emër të policisë. Por në zonën time ku ynë kam qenë zëvendëskomandant janë ato që kam thënë unë. Edhe ashtu është. Kjo si e ka lëshu, e pamë një dokument ala më herët që ishte ala ma skandaloz.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pastaj ka diçka që në anglisht është quajtur "*Legal Notice*", në fund të dokumentit që është në -- "Këshillë juridike" në shqip: "Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 24 orësh, drejtuar gjykatësit-hetues".

E shihni këtë?

PË. Është shumë interesant, nuk e di kujt iu kisha ankue, as ka pasë instanca më të larta, as nuk ka pasë më të ulëta, as ka pasë gjyqtarë, as avokat, as prokuror, ka qenë vetëm Sokol Dobruna këshilltar juridik. E kujt ka thonë me iu anku, veç me u anku te serbët, nuk di ku ka pasë me u anku. Është e çuditshme.

Nuk kemi pas struktura, z. Gjykatës. S'kemi pasë struktura. Kujt ka pasë me iu anku? As ligje.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ta shohim, do ta shohim pas pak se cila ka qenë procedura ku do ankoheshin, por mos doni të thoni që nuk e dini se për cilin bëhej fjalë këtu ku thuhet gjykatësi-hetues? Pra, e dini ju në këtë dokument se për cilin bëhej fjalë kur thuhet gjykatësi-hetues?

PË. Krejt çka di unë ka qenë Sokol Dobruna këshilltar juridik në Shtabin e Përgjithshëm. Nuk di a ka pas gjykatës, hetues, mund të jem naiv, por unë kam dashtë me e dit së pakti.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sekretaria ju lutem, nxirrni dokumentin SPOE00232264 deri në -- faqe 265-ET [sipas përkthimit] edhe me të njëjtin numër ERN në shqip.

Edhe këtu do t'ju jap kohën e nevojshme për ta parë dokumentin, pastaj ta shohim bashkë. Vetëm se na tregoni kur është nevoja me e ndërru faqen.

PË. Po, unë e pashë dokumentin deri këtu tek "Arsyetimi".

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani kalojmë në faqen tjetër. Hidhi një sy dhe mbase mund të shihni edhe nënshkrimin në fund.

PË. Po.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse kthehemi tani në faqen e parë ju lutem.

Pajtoheni, zotëri, që në dukje kjo është një aktakuzë ndaj Blerim Kuqit nga prokurori apo prokuroria e përgjithshme ushtarake që i përcillet i dërgohet, pra, gjykatës ushtarake, pajtoheni deri këtu?

PË. Në bazë të asaj që është shkrune është shumë e saktë, por unë nuk e njoh kush është ky Arben, Arben si e pat emrin ai, që është dashtë ta nënshkru, që nuk e ka nënshkru në fund të faqes, Arben Sejdiu, nuk e njoh kush është Arben Sejdiu dhe nuk i njoh këto ligje ku thotë, ligji numër kaq, kaq, ku i kanë marrën, a janë ligje ndërkombëtare apo ligjet jugosllave apo ligjet e ndonjë shteti tjetër, nuk e di çka janë thirrën se nuk ka pasë prokurori të përgjithshme. S'ka pasë gjykatë, s'ka pasë as prokuror. Unë nuk e di se çka janë thirrë dhe ku i kanë gjet këto nene. Nëse kemi pasë ne ligje, Kosova e di unë prej Dardanisë e këtej nuk ka pasë ligje të veta. Nëse janë thirrë në ligjet jugosllave mund të jetë ashtu po kush është thirrë edhe kush është Arben Sejdia unë nuk e di.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër, ju lutem 2265. Po të shihni paragrafin e parë aty sipër thuhet:

"Prokurori i Përgjithshëm ushtarak i UÇK-së në bazë të fletë-denoncimit të policisë ushtarake 5/99 të datës 16 janar '99, i ka parashtruar Gjykatës Ushtarake kërkesë për zbatimin e hetimeve e caktimin e paraburgimit më datën 17 janar '99".

Pajtoheni, zotëri, se duket, pra, në dukje i referohet atij dokumenti që pamë para pak, 5/99?

PË. Krejt në rregull është sa i përket teorisë. Në praktikë ne edhe tri vjet luftë të kishim bë nuk kishim arrit deri te kjo shkallë me pas prokurorinë e përgjithshme, gjykatën e

përgjithshme, gjykatën e lartë, gjykatën e ulët të Shtabit të Përgjithshëm, qendrore, joqendrore. Është insinuatë, është insinuatë. Për çfarë qëllimi dhe ça ka bo e kush e ka bo është për mua e panjohur. Unë nuk kam njohuri që kanë ekzistu këto struktura. Edhe me siguri do ta dija, me siguri do ta dija së pakti. Do të isha në dijeni, s'ka mundësi.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, në përgjigjen tuaj ju doni të thoni që s'keni asnjë dijeni për këto lloj procedurash për faza të ndryshme të procedurës kundër Blerim Kuqit që përshkruhen në këtë dokument?

PË. Jo vetëm për procedurat, por as për këto struktura. Është për mua diçka krejt e pakuptueshme, absurde.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk jeni të njohur me këtë?

PË. Jo, për besë jo.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Blerim Kuqi ka qenë anëtar i LDK-së, kështu?

PË. Në LDK kanë qenë të gjithë nga viti '90, po disa kanë qenë tani në strukturat për të bë ushtri, disa janë largu prej LDK-së, janë largu edhe prej Kosovës në Shqipëri. Blerim Kuqi është një prej atyne të parëve që në komunën e Therandës ka organizuar një njësi të vogël ushtarake e quajtur Lisi. Krahas kësaj ka qenë edhe një njësi tjetër e quajtur Graniti 50, që ka qenë Habib Elshani në atë tjetrin. Këto dy njësi janë bashku me 26 qershor dhe kanë formu brigadën, duke mos qenë të

kompletum as batalionet për brigadë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do ishte e drejtë nëse do thoshim që ai qëndroi, le të themi, i afiliuar, pra, i anëtarësuar në me LDK-në gjatë gjithë konfliktit. Do të pajtoheshit me këtë? Dua të them që ai qëndroi dhe ai e kam fjalën për Blerim Kuqin.

PË. Nuk e di a ka vazhdu ai por besimi ka qenë i plotë derisa është caktuar komandant brigade nga Sokol Bashota, kush është konë në shtab të përgjithshëm që e ka caktu, ka qenë besimi i plotë tek ai. Nuk mund ta di a ka qenë, a ka vazhdu të jetë në LDK akoma dhe s'është relevante, s'besoj që kjo na duhet diçka.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Transkripti ka ngrirë sërish.

Mund të vazhdoni.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po a nuk ka relevancë zotëri, sepse në dokument dhe quajeni deklaratën 16 [sipas përkthimit] marsit të '99-s, është një deklaratë që keni përpiluar me Halil Qadrakun. Është prova me numër P500. Ju në të keni identifikuar z. Kuqi me si pjesë e udhëheqësve të LDK-së, a është -- nuk është e saktë kjo?

PË. S'e besoj që e kena thonë q'ashtu, pjesë e udhëheqjes së LDK-së se s'e kam dit, realisht nuk e kam dit, as atëherë as tash. Ka mund të jetë në LDK akoma se s'ka pas nevojë se ushtria dhe LDK-ja nuk kanë qenë të ndamë. Kemi pas shumë

anëtarë të LDK-së që kanë qenë edhe -- ushtarë të mirë edhe komandantë të mirë. Për atë thashë nuk ka relevancë kjo se a ka qenë LDK a s'ka qenë. Se nuk ka qenë dy blloqe të kundërta mes veti ose të përplasura, konfrontune mes veti. Ka pas prej LDK-së në UÇK, prej UÇK-së në LDK.

Nëse ka dezertu është tjetër gjë. Dezertimi është tjetër normë, tjetër penalitet, jo anëtar i LDK-së, s'është penale.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Fakti që ju përmendët Blerim Kuqin dhe udhëheqësit e LDK-së në letrën tuaj nuk ka relevancë me këtë, nuk ka lidhje me këtë, kështu e kuptoj?

PË. Nuk e di në kontekstin e çfarë është përmend LDK aty. Nëse ka qenë në pyetje që të ruhet pushteti lokal, civil apo të jetë pushtet ushtarak i luftës, mund të jenë diçka në këtë kontekst. Po pse ka qenë anëtar ai apo ky asgjë s'e ka pengu. Nëse s'e ka kry detyrën ushtarake mirë aty është diçka tjetër.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju lexoj se çfarë është regjistruar këtu në letrën tuaj dhe komentet -- prova me numër P500 ku ju ankoheni për shumë individë të cilët sipas jush janë jobesnikë apo nuk i kryejnë mirë detyrat apo kanë mangësi të tjera. Dhe ju thoni se:

"Ky koordinim ndihmohet edhe përmes nëpërmjet, pra, Blerim Kuqit - dhe përkthyesja nuk i ka emrat e tjerë - të cilët kanë përhapur dhe përgatitur në terren në të gjithë fshatrat e Suharekës -- komunës së Suharekës duke krijuar një staf civil nga udhëheqësit e LDK-së".

Pra, pyetja ime është përse e lidhni ju z. Kuqi, z. Bytyqi me LDK-në, nëse kjo nuk do të kishte relevancë?

PË. Kjo ka qenë kështu e saktë tani qysh e si e shpjegut ju se të krijohen shtabe paralele civile karshi shtabeve luftarake nuk ka qenë e aceptueshme për ne në kohën e luftës. Edhe sot po të krisi lufta këtu në Holandë ushtria e merr përsipër organizimin. Ne kemi qenë në nivel detyre me shtabet ushtarake. Nuk kemi pas nevojë të bëjmë edhe shtabe civile tash dy lloj struktura me u përplas mes veti. Njona po pajtohet, tjetra s'po pajtohet. Në këtë kontekst është thënë. Jo pse kanë qenë anëtarë. Nuk na prish punë se kanë qenë anëtarë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E shoh. Ju lutem kalojmë te SPOE00248768 deri në 00248770. Duhet të jetë i njëjti numër, jo 48769 në shqip.

Jeni në gjendje që ta lexoni zotëri?

PË. Veç mos ma hiqni krejt. Po. Po, tani mirë është.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse mund të kemi edhe versionin në anglisht me numër SPOE00248768. Faleminderit.

Këtu duket se ka një raport pune i datës 6 maj '99. Është e lidhur me -- Gjykatën Ushtarake të UÇK-së me numër 1/99, vendndodhjen Kleçkë dhe individi nëse e çoni poshtë shikoni nënshkrimi e autorit të raportit është Agim Zogaj, roje e burgut apo drejtori i burgut.

E dini kush ka qenë Agim Zogaj?

PË. Si emër e kam njohur edhe gjatë luftës e tash, si person individ nuk e njoh. E kam pas njohur, por është e çuditshme; a janë këta të ndalum, të mbajtur, a janë të kontaktuar, a janë të marrur në pyetje unë nuk e di. Si e ka paraqit ai dokumentin është krejt në rregull. Nënshkrimi i tij është, po shihet qartë, Agim Zogaj.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, dokumenti thotë:

"Raporti përfshin periudhën nga 20 shkurti '99-s deri më 6 maj të '99-s. Poshtë në listë janë regjistruar personat të cilët janë pranuar dhe janë liruar përgjatë kësaj periudhe".

E shihni këtë që sapo ju lexova?

PË. E shoh edhe listën unë vetëm i njoh Blerim Kuqin dhe Jakup Muharremin në këtë listë. Nuk njoh njeri tjetër edhe nuk e di ku janë mbajt këta njerëz. Nëse ka që janë mbajt diku, Jakupi ka qenë deri në shtab të përgjithshëm, është kthy brenda 5-6 orëve; Blerimi ka thënë nuk jam konë i burgosur, nuk jam ndalu kurrkund. Vetë ka deklaru kështu në publik në media. Këta të tjerët nuk po i njoh asnjë, as di ku ka qenë ky vendndalim. Nuk di ku ka qenë ky vendndalim. Nëse ka bë dikush kështu prapa -- krejt shpinës, prapa shpinës tonë atëherë është konë mirë me e dit atëherë. Tash kurrgjë s'mund t'i bëjmë më.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I marrim, i marrim gjërat me radhë. A jeni në dijeni të ketë pasë një objekt ndalimi në Kleçkë në maj të '99-s?

PË. Jo, nuk jam në dijeni. Nuk jam, e po më habit ky fakt.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E supozoj se ju jeni befasuar që dhe Agim Zogaj paska qenë drejtori i burgut të këtij objekti. Kjo është diçka që ju nuk e dini, saktë?

PË. Jo, nuk e di. Për të qenë drejtor i burgut duhet me pas burg. Për të qenë drejtor i burgut duhet me pas staf, gardianë. Ata që mbajnë burgun, gjykatës që i burgos njerëzit. Nuk kanë ekzistu këto struktura. Ndoshta paska pas ai ndonjë ahër të lopëve të vetin a naj podrum ku i ka mshelë njerëzit, unë nuk e di; s'e kuptoj; jam shumë i indinjuar se tash po e kuptoj, po e shoh këtë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sepse sipas dëshmisë suaj, s'ka pasë ndonjë objekt burgu në atë zonë --

PË. Nuk njoh që ka pasë objekt burgu në zonën time.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] -- në zonën tuaj në 1998 dhe 1999.

PË. Nuk njoh vend ku ka pas ndalim njerëzish apo që është quajt burg.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim numrin 8 në këtë dokument. Blerim Kuqi dhe data në këtë dokument tregon që ai është futur në këtë objekt më 27 janar të 1999. Dhe nga dokumenti ai ka qenë ende i ndaluar në momentin që është lëshuar ky vendim. A pajtoheni me mua?

PË. Sipas dokumenteve ashtu është ju si thoni z. Gjykatës. Por është e çuditshme nëse Blerim Kuqi është dashtë me u marr

në këtë datë, këta janë kthy sa e di unë në nëntor '98-s nga Shqipëria. Pse është dashtë me 26, 27 janar '99? Kush ka hetu ata? Kush e ka bë këtë punë, nuk e di, nuk e kuptoj.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mund ta shihni te kolona e fundit te "Vërejtjet", thuhet procesi i ndalimit është bazuar me "Vendim gjykate". Pra, kështu duket të paktën nga ky dokument.

PË. Po kështu shkruan, kështu shkruan, por cila gjykatë? Nëse ka pas tjetër njeri përpos Sokol Dobrunës unë i shtie dy duart në zjarr; shkoj gjuhem, bëj vetëvrasje, unë s'kam njoh tjetërkënd që ka ekzistu.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju thatë para një momenti që ju nuk dinit gjë fare për ndonjë proces gjyqësor që t'jua kenë treguar, kështu?

PË. Jo, jo, jo.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim prapë kolonën e fundit. Te numri 1 thuhet, "Liruar nga Çeliku".

Mund të na thoni kush është Çeliku?

PË. Çeliku është pseudonimi i Fatmir Limës.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më poshtë tek 7, për Milan Mitroviqin që është mbajtur i ndaluar përreth dy javë. Dhe ka qenë ose i arrestuar ose është liruar nga "Shtabi i Përgjithshëm (Luli)". A e keni idenë për çfarë bëhet fjalë këtu kur thotë "Shtabi i Përgjithshëm (Luli)"?.

PË. Nuk e kam idenë se edhe për Çelikun edhe për Lulin ai që

ka shkru shkrimin arsyen pse e ka shkru Luli ose Çeliku ai e din për arsyeshmërinë e vet që ka bë këtu në këtë farë shkrimi. Nuk e di, s'muj -- me ngarku kërrkënd, as Çelikun pse ka pasë pseudonimin, Fatmir Limaj, as Luli pse ka pasë pseudonimin, Kadri Veseli, sepse Luli ka pasë shumë. Po këtu ky shkruesi në kontekstin e çkajit e ka shkru unë po çuditem me këto mbajtje, mbyllje, mshelje --

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Zotëri, po ju ndaloj. Po ju bëj të njëjtën pyetje që bëri dhe Gjykatësi Barthe më herët. A keni njohur ndonjë Luli tjetër ju në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së apo keni njohur vetëm një Luli?

PË. Në Shtabin e Përgjithshëm nuk kam njoft Luli tjetër. Kam njoftë në zonë tonën, në zonë të Drenicës, Dukagjin, Shtab të Përgjithshëm nuk kam njoftë Luli tjetër.

Po a ka qenë ky Luli që mendojmë ne, Kadri Veseli, dhe a ka dhënë ky urdhër me u liru apo me u burgos dikush unë s'jam shumë i sigurt në dokumentin që po e shoh. Ky që ka shkru dokumentin s'pari në këtë nuk jam i sigurt që ka qenë drejtor burgu. Ku është burgu? S'ka pas burg. Dokument i ndërtuar mbi bazën e insinuatave.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, për t'iu përgjigjur një pyetje -- të thjeshtë që ju bëra, z. Veseli, Kadri Veseli është i vetmi person që ju njihni në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së që ka pasur pseudonimin Luli, po apo jo?

PË. Po. Nuk njoh tjetër. Ndoshta ka pasë edhe të tjerë. Me

siguri ka mund të ketë, por unë nuk njoh, në Shtab të Përgjithshëm, jo.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mund të shihni numrin 17. Është një emër Sami Duga që e kanë sjellë më 22 prill të '99-s dhe është liruar pesë ditë më pas më 27 prill 99. Nga Dhjetëshi, a keni njohur ndokënd me këtë pseudonim gjatë luftës?

PË. Jo. Jo, jo. Nuk e di. S'ka shkru emër kurrgjë. "Dhjetë" ka shkru.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe thatë që bëheshin takime të rregullta apo mbledhje të rregullta me anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe ju nuk keni njohur askënd që në atë kohë të përdorte këtë pseudonim? Këto po thoni?

PË. Jo, z. Gjykatës, takime të rregullta, por hiç asnjë takim s'kam marrë pjesë në Shtab të Përgjithshëm. Kështu e kam thënë se unë kam qëndru prej fundit të dhjetori, domethënë, prej 15 dhjetorit deri 15 janar. Nuk kam njoft me këtë pseudonim, me këtë nofkë. Nuk kam marrë pjesë në mbledhjet e Shtabit të Përgjithshëm. Kam thënë që ka pas mbledhje të rregullta në nivel të zonës.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull. Shohim diçka tjetër që keni diskutuar me Mbrojtjen e z. Veseli. Ju iu përgjigjët disa pyetjeve të Gjykatësit Barthe sot paradite, por më duhet ta pranoj që ende nuk jam shumë i qartë për

dëshminë tuaj dhe ndërkohë mund të heqim dokumentin nga ekrani.

Tani e kam fjalën për rregulloret disiplinore të UÇK-së. Unë me sa kisha kuptuar, para dy javësh ju keni thënë që ju personalisht dhe Nuredin Abazi dhe më pas shtuat edhe një person të tretë sot paradite, keni qenë hartuesit e kësaj rregulloreje. Edhe unë njësoj si Gjykatësi Barthe e kuptova që ju i kishit çuar tek zyra e Adem Demaçit ku u botuan u vendos data, u ndryshua vendndodhja dhe kjo u bë rregullorja e disiplinës së UÇK-së.

Sot paradite unë e kuptova disi ndryshe dëshminë tuaj. Kështu që dua që t'ju jap një mundësi të na tregoni saktësisht çfarë dëshmie keni në lidhje me këtë pikë? A po thoni që jeni ju autori i rregullores disiplinore që ka përdor UÇK-ja në gjithë territorin e Kosovës?

Z. EMMERSON: [Përkthim] Pikë së pari, nuk ka thënë këtë. Ai ka përdorur fjalën rregullore, ai ka thënë që rregulloret nuk janë përdor asnjëherë.

Së dyti, mbase do ishte e dobishme për dëshmitarin që pyetjet mos t'ia bënit sugjestionuese dhe t'i kërkoni atij që të komentojë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Emmerson, mbajini komentet për një moment të mëvonshëm.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Po unë po ngre një kundërshtim dhe unë kam të drejtë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po nuk thatë ndonjë kundërshtim.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Është sugjestionuese dhe është një përfaqësim i pasaktë i dëshmisë së tij.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do keni mundësinë tuaj për të bërë pyetjen. Kundërshtimi juaj rrëzohet.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I lutem Sekretares të vendosë në ekran materialin me numër U0099 -- U0091614-ET.

Dëshmitar, a ju kujtohet që jua treguan këtë dokument, jua tregoi z. Emmerson këtë dokument?

PË. Po, i nderuar Gjykatës. Unë nga pamja e jashtme desha ta pranoj si dokument timin, sepse ne kemi bë rregullore në nivel të zonës, por kur doli brendia që ishte krejt *copy-paste* e një rregullore të Shqipërisë dhe pashë nënshkrimin poshtë, Fehmi Baftiu e ka nënshkru një jurist, jurist i vjetër, jurist me përvojë dhe ardhur nga -- zyra e Adem Demaçit, nuk ka hy kjo në funksion të zonës asnjëherë se ne kemi pas rregulloret tona. Unë kam mendu që është rregullorja ime dhe në apriori kam thonë po, unë e kam bë, dokumenti jem.

Kur e pashë brendinë e saj, vulën, se ne s'kemi pas vulë të tillë, vulën katrore, nënshkrimi i Fehmi Baftiut nuk muj e marr dokumentin e huj për temin. Dhe s'është praktiku kjo në zonë. Ju lutem merreni kështu reale, nuk -- nëse kam thënë që është dokument i jem e kam parë nga sipërfaqja. Kur është parë

1 në brendi se çka ka unë e kam pa që s'jam unë autori i saj.
2 Krejtësisht është e Shqipërisë, s'është as relevante për UÇK.
3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, dy gjëra tani, edhe
4 në qoftë se është nevoja unë lexoj dhe faqet. Është në
5 transkript janë faqet 10198 deri në 10200. Po dua prapë të jem
6 i qartë lidhur me atë që po thoni.
7 A po pranoni që dokumenti që është përballë nuk është
8 dokumenti juaj? Pra, nuk jeni ju autori i këtij dokumenti, e
9 pranoni apo e kundërshtoni?
10 PË. Këtë dokument nuk e pranojmë si të zonës operative të
11 Pashtrikut fare. Nuk s'kam të bëj me këtë dokument kurrgjë. As
12 s'e kam fut në praktikë as s'është zbatu as s'e kam pa më
13 përpara. Për herë të parë, z. Emmerson, Avokati, ma ka thënë
14 prej atjehit edhe unë kam mendu në sipërfaqe që është i zonës
15 teme. Kur u lexua brendia del që s'kam lidhje me këtë
16 dokument.
17 Nënshkrimi ekziston, Fehmi Baftiu; vula ekziston,
18 Prishtinë, Zyra e Adem Demaçit. Nuk e di çka është e paqartë.
19 Ju lutem, nëse unë e kam bë ndonjë lapsus apo është faji tek
20 unë keni të drejtë. Por realiteti është ky që po e them.
21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju jeni në dijeni me
22 siguri që ka pasur rregullore të disiplinës në fuqi në UÇK që
23 në fillim të '98-s apo jo? Për tërë UÇK, kështu?
24 PË. Jo, nuk ka pasë në '98. '99 kemi pasë në nivel të zonës.
25 Për tërë UÇK-në nuk e di që ka pas.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I lutem Sekretares të vendosë në ekran Provën Materiale me numrin P631, 631, 163 - më falni.

Ju lutem njihuni me përmbajtjen e dokumentit.

Pyetja e parë: A e keni parë ndonjëherë më përpara këtë dokument?

PË. Jo, nuk e kam pa. Shihet që është shkru prej Bislim Zyrapit, por nuk është nënshkrimi i Bislimit; nuk e kam pa dokumentin. Njonin prej këtyne emrave e njoha më lart, Vahid, Vahid. Më ka pas furnizu me armë në Budakovë. Nuk e di kush është ai njeri më shumë s'e njoh.

Nuk e di për kë bëhet fjalë. Po e shoh dokumentin që është i punum prej shefit të Shtabit të Përgjithshëm, Bislim Zyrapi. Ashtu e ka shkru në fund, Kolonel Bislim Zyrapi, por nuk ka nënshkrim. S'e kam pa këtë dokument. Nuk e di në cilën rregullore është thirrë. Rregullore unë kam pas në zonë, por nuk e di a ka pas në qendër a s'ka pas.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ta shohim edhe atë. Marrim me radhë. A pajtoheni se kjo duket të jetë një vendim në një proces disiplinor, në vijim të një procesi disiplinor dhe vendimi është lëshuar nga Bislim Zyrapi në cilësinë e shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Pajtoheni me këtë?

PË. Pajtohem komplet se është i dizajnum mirë, është i shkruar mirë dhe besoj që është vendimi i tillë, po pse e ka lënë të panënshkrume nuk di. Ai më mirë kish qenë ai me sqaru.

Dhe nuk e di sa është kompetencë e imja për me ia vlerësu punën e shefit të Shtabit, Bislim Zyrapit.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju pyes kështu atëherë: Me sa keni ju dijeni për funksionimin e UÇK-së, a pajtoheni që shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Kolonel Bislim Zyrapi, kishte autoritet disiplinor? Pajtoheni me këtë deklaratë?

PË. Ka pasë, ka pasë autoritet. Edhe organizativ edhe disiplinor edhe tek urdhrat, të organizimit e shumëçka.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse shohim tek "Arsyetimi", paragrafi i parë thotë që personi në fjalë në këtë proces, z. Morina nga Vranjaka "është ndaluar për shkak të shkeljes disiplinore të paraparë në nenin 17, rreshti 1 i pikës 1 së Rregullores mbi Disiplinën e UÇK-së dhe është dënuar me 25 ditë burg".

E shihni këtë?

PË. E shoh por nuk -- ka gjasa nëse është dënu për të ardhmen diçka që e ka mendu dikush me bë këtë punë. 25 ditë ku ka pas me mbajt ne, 25 ditë asnjëherë s'jemi konë me një pozicion. Pozicionet tona si UÇK dhe si struktura kanë lëviz brenda jave. Kush e mban atë 25 ditë e nuk di ku kanë mujt me e mbajt. Ky dokument ka mujt me u shkru edhe prej dikujt tjetër, emri i Bislimit, por është mirë me e pyet Bislim Zyrapin. Ai e vërteton.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por për momentin unë po ju

pyes ju, a pajtoheni ju që më 10 këtu thotë, pra, më -- këtë vendim që është i dhjetorit ’98, aktvendimin që kemi përballë, përmban dy referenca. I referohet dy herë: Pra, përmend dy herë rregulloren e disiplinës së UÇK-së, a pajtoheni me këtë?

PË. Një herë, së pari, nuk pajtona që ka pasë me 1998 rregullore; e dyta nuk pajtohem që ka pasë burg dhe mundësi me mbajt dikë 25 ditë. Absolut s’pajtohem.

Të tjerat sesi kanë ndodh edhe pse qysh ka ardhë ky dokument, është mirë me bisedu me shefin vetë. Edhe këtë vajzën këtu Vjollca Mali, s’e njoh. Nuk e njoh këtë, kush ka shkru.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ju nuk keni dijeni për ndonjë burg e rregullore të disiplinës në UÇK në ’98, saktë?

PË. Jo, nuk kam dijeni, nuk kam dijeni. Për atë jemi detyru në ’99 me i bë vetë. Zona operative e UÇK-së i ka bë vetë rregulloret.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të shohin dokument me numër IT-05-87 P02464-E edhe 46 [sipas përkthimit] dhe ka edhe përkthimin në gjuhe shqipe dhe përfundon me AT në fund.

PË. Në shqip nuk e kam.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do dali dhe shqipja për një sekondë. Po e kërkoj ndërkohë. Një -- lexojeni. Dëshmitar, ky është një urdhër nga komandant Ekrem Rexha, Drini. Ka datën 1 shkurt 1999. A pajtoheni që ky duket të jetë një urdhër në

bazë të të cilit merren masa disiplinore ndaj një anëtari të UÇK-së; pajtoheni me këtë?

PË. Unë s'e besoj që Drini ka lëshu urdhër me ndalu kërrkënd. Së pari kisha me thënë nuk ka qenë njeri i tillë, ka qenë shumë njeri i kulturum edhe ka pas nivel, respekt për civilët për popull. Këtu thuhet që Hasan Bej, Hasan O. Bej me u ndalu 48 orë. Nuk e di as kush është ky njeri, emër. S'e besoj, nuk e di. Dikush e ka bë ama, s'e besoj që Drini e ka bë. Nuk po e njoh nënshkrimin. Ka pa nënshkrimin e Drinit por këtë s'po e njoh.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I marrim me radhë. A pajtoheni që ky dokument me datën 1 shkurt '99 përmend po ashtu rregulloren e disiplinës së Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së? Pra, ky urdhër në bazë të kësaj rregullore është lëshuar, a pajtoheni?

PË. Po, pajtohem. E përmend atë, por ka mundësi me u marrë edhe në bazë të rregullores së zonës së Pashtrikut. Ndoshta ka pasë ndonjë rregullore në Shtab të Përgjithshëm që unë s'e kam dit. Pajtohem plotësisht, ashtu qysh po shkrun duhet me u konë, por kush e ka bë shkrimin edhe kush është nënshkruesi nuk e di. Se në këtë kohë ka pas rregullore. Ose rregullorja e zonës ose e Shtabit, po Shtabi s'e di a ka pas Shtabi i Përgjithshëm rregullore. Nuk kam njohuri.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Është e drejtë të themi, bazuar në sapo atë që thatë, atë që dëgjova që ju s'e keni

parë ndonjëherë përpara këtë urdhër, saktë?

PË. Jo, nuk e kam pa. Jo, jo. Jo s'e kam pa.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Personi që është objekt i kësaj mase është Hasan O. Bej, e shihni emrin?

PË. Në realitet kurrë s'kam dëgju ksi mbiemri. Hasan po, Bej nuk e di çka është. O. Bej nuk di kush kush është ky nuk di. Nuk ka te ne mbiemër të tillë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po në Turqi, po.

PË. E ka mundësi turqisht, ka mundësi turqisht, ka mundësi.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sepse mund të jetë, a nuk është ky personi që u arratis bashkë me z. - përkthyesi nuk e kapi emri, ju kërkoj ndjesë - me mbiemrin, me z. Syl Kollqaku.

PË. Shumë të drejtë keni. E kuptova, e kuptova për kën e keni fjalën. Hasan e ka pasë emrin, po mbiemrin nuk e di. Hasan emrin e ka pasë ai. Mbiemrin nuk e di dhe nuk e di si ka mund të japë ndonjë urdhër Drini kundër shoqëruesit të Sylejman Kollqakut që janë kanë bashkë Drini dhe Syla. Ka mujt vetë Sylejman Kollqaku si zëvendëskomandant me dhënë këtë urdhër, jo Drini. Nëse është ai Hasan, ai mundet ka mundësi ky mbiemër me qenë turk. Hasan e ka pas emrin, e di, por mbiemrin nuk e di.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A pajtoheni apo e kundërshtoni faktin që Drini ka pasur autoritetin për të lëshuar urdhra të tillë?

PË. S'ka pasë autoritet, por nuk e di ku kish mbajt të

ndalum. Vend për ndalim nuk e di, s'kemi pasë. Autoritet ka pasë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dëshiroj t'ju pyes për diçka tjetër. Ua kanë treguar edhe këtë dokument. Është Prova Materiale P706 [sipas përkthimit] 716.

Dëshmitar, a ju kujtohet që jua shfaqën para dy javësh këtë dokument?

PË. Ta shoh edhe pak. Më duket që e kam parë. Veç ma lejoni ta shoh deri në fund. Po, po, po e kam parë këtë dokument.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet, ju pyetën për një referencë që është në këtë dokument. Ju thatë,

"Ndonëse -- ".

Është paragrafi 1:

"Ndonëse do të vuaj gjithë jetën për shkak të këtij incidenti, do t'i përgjigjet edhe gjykatës së shkallës së dytë".

A ju kujtohet që ju bënë pyetje për këtë gjë këtu?

PË. Po, pyetja është bërë. Këtu është fjala për një plagosje pa dashje një ushtarit Kryeziu mbiemri, i Brigadës 122 dhe është lëshuar një -- urdhër, ta them ashtu, për Brigadën 124 dhe 122 se kanë qenë bashkëfuzionume një kohë të gjatë që të mos mbajnë në tytë fishekun për shkak se kanë mundësi aksidentalisht të plagosen ushtarët dhe kjo është bazuar në një rregullore të zonës operative të Pashtrikut. Ne kemi pasë rregulloret tona.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kur ju bënë pyetje, konkretisht për këtë fjali. Këtë pyetje jua kanë bërë më datë 13 nëntor 2023, ju keni thënë kështu:

"Po i vendosni njëri mbi njeri tjetrin, ky nuk është e paqëllimshme...".

Kjo ka qenë përgjigjja që ia keni dhënë z. Emmerson.

"...sepse më pas, përpara kësaj është bërë një kërkesë Shtabit të Përgjithshëm ku kërkohej që të themeloheshin gjykata për të trajtuar aspektet disiplinore lidhur me ushtarët. Se kishim ushtarë që mbushnin armët dhe aksidentalisht plagosnin apo vrisnin personat. Kështu që për mendimin tonë, duhej të krijoheshin gjykata. Kjo mendohej në qoftë se lufta do zgjaste një, a dy apo tre vjet. Përndryshe nuk ishte pse të kishte gjykata".

Kur keni thënë që shpresonin të kishit gjykata, ju e kishit fjalën për zonat, aty e kishit fjalën për zonën tuaj?

PË. Ne e kishim fjalën për zonën tonë, por edhe kemi mendu në tërësi me pas, sepse kësij aksidente kanë ndodh edhe në zonën e Nerodimës aksidentalisht është vra një ushtar pahiri, domethënë, pa dashje. Dhe pikërisht për këto çrregullime, për këto rrethana kemi lyp me pas diçka disiplinore, struktura që kishin me disiplinu ushtarët.

Në këtë aspekt kena lyp që të kemi burgje, të kemi gjykata, të kemi struktura. Ajo kërkesë ka qenë shumë me vend, por shumë e parakohshme. Ajo është realizu ndoshta mbas dy-tri

viteve. Kështu e kam thënë edhe s'besoj që ka ndryshim.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, përfunduat për dëshminë -- për ditën e sotme me dëshminë tuaj. Do të rishihemi nesër në orën 09.00. Mos harroni që nuk duhet të flisni lidhur me këtë çështje me asnjë person jashtë sallës së gjyqit.

Asistenti, ju lutem shoqërojeni dëshmitarin jashtë sallës.

DËSHMITARI: Faleminderit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shihemi nesër në orën 09.00.

--- Seanca mbyllet në orën 16.01